



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**MBI**  
**(Auditimin Financiar)**

**“BASHKIA DEVOLL”**

**Tiranë, Shtator 2024**

## PËRMBAJTJA

<b><u>I. Përmbledhje ekzekutive</u></b> .....	4
1.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit .....	6
<b><u>II. Hyrja</u></b> .....	<b>6</b>
<b><u>1. Objektivat e auditimit</u></b> .....	7
<b><u>2. Qëllimi i auditimit</u></b> .....	7
<b><u>3. Identifikimi i çështjes</u></b> .....	8
<b><u>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u></b> .....	8
<b><u>5. Përgjegjësitë e audituesve</u></b> .....	8
<b><u>6. Kriteret e vlerësimit</u></b> .....	9
<b><u>7. Standardet e auditimit</u></b> .....	9
<b><u>8. Metodologjia e auditimit</u></b> .....	9
<b><u>9. Dokumentimi i auditimit</u></b> .....	9
<b><u>III. REZULTATET E AUDITIMIT</u></b> .....	10
1 Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik .....	10
2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit .....	23
3. Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave .....	30
4 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- .....	38
5. Auditimi mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet, Kullotat) të transferuara me VKM. ....	57
<b><u>IV GJETJE DHE REKOMANDIME</u></b> .....	61
<b><u>ANEKSET</u></b> .....	68
<b><u>VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT</u></b> .....	78

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## **II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar në Bashkinë Devoll, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 12.06.2024 deri në datën 19.07.2024 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar të Bashkisë Devoll” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 6 akt-konstatime. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Devoll si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### **c. Qëllimi i auditimit**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Devoll. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 16 gjetje dhe ka dhënë 18 rekomandime, nga ku masa organizative me 12 gjetje dhe 14 rekomandime si dhe 4 gjetje-rekomandime në vlerën **58,553 mijë lekë** në fushën e të ardhurave.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

**-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të munguara në vlerën **30,285 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjare.
- Të ardhura të munguara në vlerën **1,589 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 25 persona debitorë.
- Të ardhura të munguara në vlerën **26,079 mijë lekë** nga mos arkëtimi i kontratave të qirave.

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve**

Nga auditimi rezultoi se Devoll ka në total 2,987 pasuri nga të cilat 1,403 pasuri në pronësi dhe 1,596 pasur në përdorim sipas VKM-ve përkatëse nga ku rezulton se nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të asetëve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Devoll; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Korçë si dhe nuk ka krijuar komisionit e përbashkët në zbatim të VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK ku kërkohet një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit me qëllim inventarizimin dhe regjistrimin dhe përditësimin e inventarve.

**g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Sektori i Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore,

Titullari i Bashkisë Devoll të gjitha masat e menjëhershme duke i kërkuar ASHK-së Korçë caktimin e një personi ekspert të fushës, që merret me Menaxhimin e Aseteve, me qëllim ngritjen e grupit të përbashkët për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM.

Drejtorja e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave në Bashkinë Devoll, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën **58,553 mijë lekë**.

**I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

**A.OPINIONI I AUDITIMIT**

**Opinion mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2023:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Devoll janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

**Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të

tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 17.9 milion lekë, nga ku rezultuan anomalitë e mëposhtme:

-Llogaria 202 Studime dhe kërkime” janë përfshirë përfshirë 3 (tre) projekte “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën **1,562,000 lekë**, Ndertim ujësjellësi të jashtëm dhe të brendshëm, NJA Miras në vlerën **6,887,520 lekë**, Projektim Ujësllës i brendshëm në NJA Miras, nga E. në vlerë **6,960,000 lekë** (kosto historike), duke mbivlerësuar këtë llogari. Këto projekte nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin janë hartuar këto projekte ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar mbi vlerën e investimit.

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” e aktiveve afatgjata materiale, ka të pa analizuar vlerën 94,936,727 lekë dhe nuk dihet se kujt objekt i përket.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” ka të pa analizuar vlerën 572,125,235 lekë, pa emërtim objekti.

-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” rezultojnë në fillim të vitit 2023 janë në vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit poashtu 0 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2023 është paraqitur i nënvlerësuar në vlerën 7,762 mijë lekë, në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” të aksioneve të “Shoqëria Rajonale e Ujësllës Kanalizime Korçë Sh.A me NUIS M.....N”, me qëllim paraqitjen e saktë të vlerave kontabël në pasqyrat financiare.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 150,085,559 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën **2,539,409 lekë** dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera **58,553,508 lekë** e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të biznesit, familjarë dhe detyrime kontraktuale. Për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore.

## I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 751/1 prot., datë 07.06.2024, ndryshuar me shkresën nr. 751/2 prot., datë 08.07.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 12.06.2024 deri në datën 19.07.2024, në subjektin Bashkia Devoll u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.H. I. – Përgjegjës Grupi
- 2.R. L. – Anëtar
- 3.H. M. - Anëtar

### 1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Devoll kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj,

duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>1</sup>;

- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

## **2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Devoll është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

## **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Devoll dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
2. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
3. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

## **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Devoll është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e

---

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Devoll. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Devoll grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Devoll me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

#### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>2</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J<sup>a</sup> aplikon<sup>3</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes

---

<sup>2</sup> ISSAI 1315

<sup>3</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **III. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

### **1. Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia e Devoll: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës. etj
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik [GMS]
5. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit;
6. Regjistrin e riskut
7. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit;
8. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për bashkinë e Devoll, dërguar me E-mail @bashkiaDevoll.gov.al
9. Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Devoll, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:  
➤ Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Devoll, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i kontrollit*”, “*Menaxhimi i riskut*”, “*Aktivitetet e kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa shtesa dhe ndryshime*”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

**Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.**

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.

-Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Devoll në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.

-Në nenin 4 të Rregullores, ku përshkruhet përbërja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integritit European, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj drejtorie së bashku me punonjësit e saj, vihet re mos permendja e tyre si dhe përshkrimi në strukture sa me evidente të detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integritit european dhe specialistë për çështjet e diasporës, migracionit dhe integritit european. Këto dy pozicione jo vetëm që kanë përgjegjësi e detyra të ngjashme me njëra tjetrën, por duhet të përshtaten me profilin dhe përshkrimin e punës së kësaj Drejtorie. Këto dy pozicione do të ishin më përshtatshme në Drejtorinë Juridike dhe sektorët e saj.

-Në Drejtorinë e sipërcituar parashikohet pozicioni i punës Specialist për, Pronat dhe Asetet, Ujitjen dhe Kullimin, i cili parashikon disa detyra dhe përgjegjësi mbi pronat, pyjet, per gryerjet, ujitjen, vaditjen dhe rindërtimin e sistemeve të tyre në rast dëmtimi të tyre. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujrave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujrave, i cili konkretisht mbikqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe struktura e drejtorise se Aseteve. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujrave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujrave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuar në Rregulloren e institucionit si dhe Sektor te Administrimit e Manaxhimit të Pronave .

-Për vitin 2023, Bashkia Devoll ka miratuar Strukturën dhe Organigramën e saj me Urdhërin e Kryetarit nr. 09 datë 27.01.2023 dhe te aprovuar nga Prefektura Koçë në Vendimit nr.91 datë 20.12.2022 dhe nr 1140/1 Prot., ku përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë prej 395 punonjësish, nga të cilët në fakt janë 378 punonjes pra me vakanca 17 punonjes, nga numri i pergjithshem i punonjsve rezultojnë se 86 janë punonjes me statusin e sherbimit civil dhe 304 janë me kontrata pune në Bashkin Devoll.

#### **Të dhënat për pozicionet e punës në Bashkinë Devoll për vitin 2023**

Numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës	Numri i pozicioneve me Kod Pune			Numri i pozicioneve në Shërbim Civil		
	Plan	Fakt	Vakant	Plan	Fakt	Vakant
395	309	304	5	86	69	17

-Për vitin 2023, Bashkia Devoll ushtruar veprimtarinë e saj nëpërmjet Rregullores së brendshme të institucionit me nr Vendimi 97, datë 29.12.2022. Bashkia nuk ka pasur një Kod Etike të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë me vitin 2023 me nr 2298 prot. Datë 27.07.2023, për

dispozitat qe rregullojnë etikën dhe disiplinën e administratës së institucionit janë integruar në Rregulloren e institucionit te miratuar ne VKB nr.91 datë 20.12.2022 me nr 1229 prot. Në bazë të pyetësorit dërguar njësisive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike” Megjithse në vitin 2024 sipas Urdhërit me nr 66 datë 07.03.2023 kane ngritur dhe ka funksjonuar sistemi i Menaxhimit të Riskut në Bashkinë Devoll me nr.shkrese 803 prot.datë 0703.2023.

-Bashkia Devoll ka hartuar dhe krijuar Rregulloren “Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Konfidencialitetin me sipas rasteve dhe Rregullores “Për Hetimin Administrativ dhe Kërkesën e Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja”, si dhe është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm që ka funksjonuar sipas sistemit elektronik. Për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Sipas Rregullores së institucionit, ankesat nga qytetarët mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sektorin e marrëdhënieve me publikun). Rregullorja përcakton se përgjigjet lidhur me ankesat e paraqitura siglohen nga specialisti, drejtuesi i njësisë së menaxhimit dhe drejtori i përgjithshëm e me pas firmosen nga Kryetari i Bashkisë. Përveç dorëzimit të ankesave në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Rregullorja e Institucionit të saj parashikon se qytetarët kanë të drejtë të takojnë personalisht Kryetarin e Bashkisë për problemet e tyre, në ditët dhe orët e përcaktuar specifikisht në Rregullore.

**Në lidhje me parimin nr 2** “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

- Për periudhën vitin 2023, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MFE.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

-Bashkia Devoll nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.

-Bashkia Devoll nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objektet, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

**Në lidhje me parimin 4** “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

Punësimi në Bashkinë e Devoll bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë së Devoll:

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

-Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

-Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

-Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Devoll hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit

maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Devoll” për çdo vit ushtrimor.

-Punonjësit e Bashkisë Devoll trajnohen në bazë të kalendarit të trajnimeve vjetore të ASPA, për ata punonjës që të cilët janë punësuar sipas dispozitave të Ligjit për Nepunësin Civil. Bashkia Devoll nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me anë të Kodit të Punës. Mungesa e një plani të brendshëm trajnimesh bie në kundërshtim me Kreun III, paragrafin 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

-Për vitin 2023 janë larguar 123 punonjës, ndërsa janë rekrutuar 122 punonjës.

-Për Bashkinë Devoll, Kordinator të Riskut është z. M. H. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës .

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është z.A. F., i cila mban pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njëjësive të Qeverisjes Vendore”, është ngritur GMS ku është miratuar draft-projekti PBA 2023-2025, projekt-buxheti për vitin 2023, si dhe deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporte për funksionimin e kontrollit të brendshëm. Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2016 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njëjësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik(GMS) rezultoi se:

-Bashkia Devoll nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 2.3.

- Procesverbalet e Mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2023 janë të paprotokolluara, si dhe u konstatua mungesa e firmave të disa anëtarëve të GMS, duke ardhur kështu në kundërshtim me nenin 18 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

-Nuk ka mbajtur rregjister rrishtit me të dhënat e kostatuar, problematkat e ndjekura si dhe delegimin e tyre sipas sektorve te saj .

## **II.Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

**Në lidhje me parimin 6:** Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Devoll përcaktohen objektiva sasiore (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk është hartuar plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm të Bashkisë Devoll, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

**Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

-Bashkia Devoll ka hartuar dhe ka miratuar regjistrin e riskut.

-Në Bashkinë Devoll nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15 dt 20.07.2016 pika 3.2.3, si dhe në kundërshtim me në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

-Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

### **III.Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”**

**Në lidhje me parimin 10:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrollit”.

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë të identifikuar edhe proceset e punës.

-Urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues.

-Bashkia Devoll nuk ka hartuar “Planin e Veprimit e Kontrollit për Kontrollin e Brendshëm” në kundërshtim me paragrafin 3.3, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financiare(NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhërat e krijimit dhe funksionimit, komisionit të përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike,njësia e prokurimit,komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve

-Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për të janë hapur kartelat e Zyrtare dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësi.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Devoll.

-Bashkia Devoll në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

-Titullari i Bashkisë Devoll nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

**Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Bashkia Devoll nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

-Bashkia Devoll nuk ka një sistem elektronik back-up për të dhënat e institucionit.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. Aktualisht Bashkia Devoll nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë aspekt në institucion-

-Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

**Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar dhe ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

-Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike dhe Financave, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjeve ditareve, hartime PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartime listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”**

##### **Në lidhje me parimin 13:**

Bashkia Devoll disponon faqen e saj të ëeb-it [@.bashkiaDevoll.gov.al](mailto:@.bashkiaDevoll.gov.al)

Në këtë web faqe pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

-Çdo drejtori ka e-mail zyrtar dhe është e përcaktuar apo menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë.

-Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal, shkresor dhe atë elektronik, i cili rregullohet në nenin 35 të Rregullores së brendshme.

#### **V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”**

**Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin bashkisë. Raportimet e drejtuesve të sektorëve dhe drejtorive bëhen në mënyrë verbale drejtuar eprorëve.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet hartohet cdo 4 muaj, dhe është dorëzuar brenda afateve në MFE.

-Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve e strukturave, hartimit e deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, si dhe me anë të njësisë të auditimit të brendshëm, e cila vepron sipas një plani vjetor dhe strategjik të miratuar nga titullari i institucionit.

Në Monitorim të dergim Raportit të Monitorimit sipas 4 mujorve rezulton se janë derguar shkresat me nr. 1456 prot, datë 29.02.2023, shkresa me nr. 3513 prot, datë 30.05.2023 dhe shkresa me nr. 3708 prot, datë 22.09.2023 si dhe analizën financiare me nr 661 prot, datë 01.02.2024.

-Bashkia Devoll lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2023 me shkresën përcjellëse me datë 23.05.2024. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet në mënyrë të përmbledhur problematikat në 5 komponentët e MFK dhe është përgjithësisht në përputhje me problematikat e evidentuara në këtë akt konstatimi. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për

problematikat e caktuara. Nuk është konstatuar nga ana e institucionit paligjshmëria e pjesëmarrjes së Drejtorit të Ekonomisë dhe Financës në Njësinë e Prokurimit.

**Në lidhje me parimin 17:** “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.

**Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi:**

1. Z. E. D., kryetar i Bashkisë Devoll.
2. Zj.E. H., nën/Kryetare e Bashkisë Devoll.
3. Zj. M. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të financës/Koordinator i Riskut.
4. Zj. A. H. me detyrë ish-Drejtor i Burimeve Njerëzore.

## 1.2 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2023, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendim Këshillit Bashkiak nr.91, datë 20.12.2022 “Per miratimin e buxhetit,numrin maksimal të punonjësve të Bashkose dhe të Ndërmarrjeve varse te bashkisë për vitin 2023” të miratuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.02/1 prot datë 06.01.2023,duke pasur në strukturën e Auditit të Brendshëm dy punonjës. Përgjegjësi i kësaj njësie është zj A K dhe specialist E. S., pra mugesë persineli në sektorin e Auditit të brendshëm .

Struktura e njësisë AB për periudhën2023

Nr	2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi
1	A. K.	Përgjegjës	i lartë	16	7vjet	i çertifikuar
2	E. S.	Specialiste	i lartë	29	4vjet	i certifikuar

### **-Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës se burimeve njerëzore në Bashkinë Devoll, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2023, është organizuar me 3 (tre) punonjës, në nivel sektori me strukturë 1 (një) përgjegjës sektori dhe 2(dy) auditues plan .

Në fakt kjo njësi gjatë vitit 2023, kishte në përbërjen e saj 2(dy) punonjës, përkatësisht 1(një) përgjegjës dhe dhe 1(një)specialist, ku profili arsimor i gjithë stafit të kësaj njësie auditimi, rezulton që të jenë i diplomuar në fushën e ekonomisë, ku i gjithë stafi është i çertifikuar, me përvojë pune në fushën e auditimit dhe mbi 4 vjet dhe përvojë profesionale në fushën ku janë diplomuar, duke filluar nga 16-29 vjet vjetërsi ne punë.

Struktura e kësaj njësie auditimi, ne formë tabelore për periudhën e audituar per vitin 2023, paraqitet si me poshtë:

Për vitin 2023 auditime të planifikuara 6 (gjashtë)dhe të realizuara 6(gjashtë),sipas programeve mujore të auditimeve të miratuara nga Kryetari i Bashkisë,sipas planit vjetor të miratuar nga Kryetari i bashkisë Devoll me nr.3196/1Prot,datë 17.10.2022 .

1.Programi i Angazhimit të Auditimit , Drejtoria e të Ardhurave Lejave dhe Liçencave , miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.413/1,datë01.02.2023 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me,nr.413prot,datë01.02.2023.2.Programi i Angazhimit të Auditimit ,Sektori i Emergjencave Civile, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.1021/1prot,datë28.03.2023 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.1021prot, datë 28.03.2023.

3. Programi i Angazhimit të Auditimit , Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.1532/1Prot,datë 22.05.2023 dhe njoftimi për fillimin të auditimit me nr.1532 Prot,datë 22.05.2023.

4. Programi i Angazhimit të Auditimit , Sektori Juridik,prokurimeve,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2258/1Prot,datë 24.07.2023 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.2258 prot,datë24.07.2023.

5. Programi i Angazhimit të Auditimit , Sektori i Planifikim dhe Zhvillim Territori ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2935/1Prot,datë 21.09.2023 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.2935 prot,datë 21.09.2023.

6. Programi i Angazhimit të Auditimit, Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit,për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.3635/1Prot,datë 03.11.2023 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.3635Prot,datë 03.11.2023.

Për vitin 2023 nga angazhimet e auditimit të kryera janë lënë 25- rekomandime nga të cilat 15 rekomandime të zbatuara dhe 5 rekomandime në proces zbatimi dhe 5 rekomandime të pazbatuara.Rekomandimet e lëna janë pranuar nga subjekti i audituar i cili ka hartuar *PLAN-VEPRIMI, mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar. Mbahet një sistem nga sektori i auditit të brendshëm mbi ndjekjen e zbatimit e rekomandimeve,duke njoftuar menaxhimin dhe duke marrë informacion nga menaxhimi për ecurinë e rekomandimeve e duke mbajtur në një sistem për zbatimin e rekomandimeve deri në zbatimin e plotë të tyre* . Informohet Kryetari i Bashkisë Devoll mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga vleresimi i kryer mbi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit te veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, konstaton se dokumentacioni baze mbi te cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si me poshtë:

**1.Karta e Auditimit të Brendshëm** në Njësisë së Auditimit Bashkia Devoll, miratuar me shkresë të Kryetarit të Bashkisë nr.4206 Prot, datë 19.12.2023,si dhe ky dokument është dërguar për informacion Drejtorisë se Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresë nr. 4206/1Prot, datë 19.12.2023,sipas përcaktimeve të gërmës b të pikes 2.6.1 të kapitullit II të Manualit të Auditimit të Brendshëm,të ndryshuar.

**2. Plani strategjik si dhe plani vjetor**, per vitin 2023, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të MABP, si dhe te nenit 14, te ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm ( kap. III ), pika 3.5 “*Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm*”, Planet strategjike dhe vjetore të punes së Auditit të Brendshëm të miratuara nga Titullari i Bashkisë,për vitin 2023 miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën me nr.3196/1,datë 17.10.2022,pas diskutimit me menaxhimin e lartë.

Shkresat për dërgimin e planeve/dhe evidencave tek Njësia Qendrore Për Harmonizimin e AB, në Ministrinë e Financave?

Planet strategjike dhe vjetore të punes së Auditit të Brendshëm të miratuara nga Titullari i Bashkisë Devoll,për vitin 2023 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Finnaciari Publik;Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm Tiranë me shkresën me nr. 3196/1,datë 17.10.2022.

Planet vjetore të auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kriteret e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planet vjetore të auditimit janë përfshire për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë, ku drejtimet kryesore të auditimit kanë qënë:

-Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, si nga audituesit e brendshëm po kështu dhe nga auditimet e realizuara nga audituesit e jashtëm ( KLSH)ështëkryer në çdo angazhim auditimi.

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në përputhje me legjislacionin, për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës së njësisë qeverisjes vendore.

-Verifikimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm, Verifikimi i riskut të subjektit,

-Verifikimi i pajtueshmërisë së veprimtarisë së drejtimit me politikat, rregullat dhe legjislacionin,Informacioni dhe komunikimi,monitorimi. –Vlerësimi i strukturës është kryer në çdo angazhim auditimi .

-Vlerësimi i veprimtarisë së entitetit mbi menaxhimin efektiv të menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore,vjelja e gjobave ,menaxhimi i aseteve toka, pyje, kullota,pagat,artikulli 602(shpenzime operative) menaxhimi i shërbimeve publike.

-Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura.

-Vlerësimi i rregullshmërisë ligjore baze dhe mbështetëse si dhe rregullorja që drejton veprimtarinë e subjektit.

Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësoin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 449/1prot, datë 12.02.2024 për vitin 2023.

Është bërë edhe dërgimi i informacionit mbi raportimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm në Bashkinë Devoll për vitin 2023 në **Këshillin Bashkiak** sipas shkresës me nr.675 prot, datë 24.02.2023, informim i Këshillit Bashkiak Bashkia Devoll mbi Planin vjetor dhe Strategjik të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm për vitet 2024-2026. Informacion mbi monitorimin ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditit i brendshëm për vitin 2022, **Këshillit Bashkiak Bashkia Devoll**, me shkresën nr.1304 prot, datë27.04.2023 . Raportime të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditit të brendshëm, periudha Janar-Gusht 2022, Zv/Kryetareve të Bashkisë Devoll me shkresën me nr.2941 prot, datë 02.09.2022.

Veprimtaria e AB për periudhën 2023, i është përmbajtur Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”,I ndyshuar, planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet ndërkombëtare procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB, e cila paraqitet si me poshtë:

• Auditim në Drejtoria e të Ardhurave Lejave dhe Liçencave 1 Auditim Përputhshmëri.

- Njoftimi për fillimin e auditimit në Drejtorinë e të Ardhurave Lejave dhe Liçencave me shkresën nr.413 Prot, datë 01.02.2023.

- Programi i Angazhimit të Auditimit për Drejtorinë e të Ardhurave Lejave dhe Liçencave, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën nr.413/1,datë01.02.2023.

• Auditim në Sektori i Emergjencave Civile1 Auditim Performancë.

-Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektorin e Emergjencave Civile me shkresën nr.1021 Prot, datë 28.03.2023.

- Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektori i Emergjencave Civile, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën nr.1021/1, datë 28.03.2023.

• Auditim në Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit. 1 Auditim Përputhshmëri dhe i Kombinuar.

- Njoftimi për fillimin e auditimit në Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit. me shkresën nr.1532 Prot, datë 22.05.2023.

- Programi i Angazhimit të Auditimit për Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit., miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën nr.1532/1, datë 22.05.2023.
  - Auditim në Sektori Juridik dhe Prokurimeve. 1 Auditim Perputhshmëri.
- Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektori Juridik dhe Prokurimeve me shkresën nr.2258 Prot, datë 24.07.2023.
- Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektori Juridik dhe Prokurimeve, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën nr.2258/1 prot., datë 24.07.2023.
  - Auditim në Sektori i Planifikim dhe Zhvillim Territorit. 1 Auditim Përputhshmëri.
- Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektori i Planifikim dhe Zhvillim Territori. me shkresën nr.2935 Prot, datë 21.09.2023.
- Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektori i Planifikim dhe Zhvillim Territori. ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën nr.2935/1, datë 21.09.2023.
  - Auditim në Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, për auditimin e analizës së situatës për detyrimevet e prapambetura (Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll 1 Auditim Përputhshmëri.
- Njoftimi për fillimin e auditimit në Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit,për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura me shkresën nr.3635 Prot, datë 03.11.2023.
- Programi i Angazhimit të Auditimit për Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit,për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me shkresën nr.3635/1, datë 03.11.2023.

**1. Nga auditimi i pranimit, vlerësimit dhe zbatimit të rekomandimeve në *Bashkinë Devoll*, angazhim i realizuar me program angazhim auditimi të veçantë për vitin 2023 dhe rezultatet e monitorimit janë raportuar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.86/5 Prot,datë29.03.2024 “Raport “Mbi vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit 2023”.**

Pas përfundimit të auditimeve të realizuara të realizuar për veprimtarinë e periudhës 2023, *janë lënë gjithsejt 25 rekomandime*, nga të cilat *janë pranuar 25 rekomandime*, kjo e pasqyruar në planin e veprimit të hartuar dhe miratuar nga subjekti i audituar nga të cilat 25 rekomandime të pranura 15 rekomandime të zbatuara dhe 5 rekomandime në proces zbatimi dhe 5 rekomandime të pazbatuara .

- **Rekomandime të karakterit organizative**, janë dhënë dhe *pranuar 2 rekomandime*.

- **Rekomandime të karakterit për arkëtim**, janë dhënë dhe *pranuar 0 rekomandim*.

- **Rekomandime të karakterit të tjera**, janë dhënë dhe *pranuar 23 rekomandime*.

Është dërguar informacion në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Tiranë me shkresën me nr. 86/5 prot, datë 29.03.2024 “Raport “Mbi vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditi i brendshëm gjatë vitit 2023”, së bashku me pasqyrat përkatëse.

### **1. Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.**

Nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm Bashkia Devoll, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “*Planifikimi i një angazhimi*”, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit.

Gjate kryerjes së angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimin për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e pavarësisë, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtëmeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 “Përgatitja e programit të angazhimit...”, ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm: Zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri tjetrin.

- Verifikimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm.
- Verifikimi i riskut të subjektit.
- Verifikimi i pajtueshmërisë së veprimtarisë së drejtimit me politikën, rregullat dhe legjisllacionin.
- Informacioni dhe komunikimi
- Monitorimi

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin MF nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

## **2. Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.**

Nga NJAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditimi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II të MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, e konkretisht:

- *Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit.*
- *Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit.*
- *Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit.*
- *Programi i angazhimit të auditimit.*
- *Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit.*
- *Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.*
- *Takimi i ballafaqimit përfundimtar të misionit të auditimit.*
- *Projekt Raporti i auditimit.*
- *Raporti Përfundimtar i auditimit.*
- *Memo ( përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit.*
- *Monitorimi i brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues.*
- *Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim.*

### 3.Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese.

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

### 4.Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.

Nga njësia e AB të bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Në mënyrë të detajuar planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2023 paraqitet si vijon:

#### **Pasqyrat e planifikimit dhe realizimit për vitin 2023.**

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Auditim e ta planifikuar	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				Performace	Të tjera
				Perputh	Financ	Kombi			
1	Viti 2023	6	6	4		Perputhshmëri dhe i kombinuar		1	1

#### *Masat organizative të lena në vitin 2023*

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej numër	ne Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej numër	ne Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2023	25	15	5	5				
<b>TOTALI</b>		<b>25</b>	<b>15</b>	<b>5</b>	<b>5</b>				

#### ➤ **Institucioni sinjalizues**

Institucioni ka Njësi përgjegjëse të Sinjalizimit të Brendshëm bazuar në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për vitin 2022 nuk ka pasur ndryshime funksionon sipas Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Devoll Z.E. D. me nr.346/1, datë 04.12.2019. Përgjegjës për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, sinjalizuesit janë:

- 1.E. S.
- 2.A. K.

Në bazë të brendshme të rregullimit të funksioneve të sinjalizuesit rrezultojnë në zbatim të pikës 4, neni 24 “Nxjerrja e akteve nënligjore të ligjit 60/2016, i ndryshuar, janë hartuar e miratuar rregulloret e sinjalizimit të brendshëm si:

-Rregullorën “Për hetimin administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit në Institucionin e Bashkisë Devoll” miratuar me Urdhërin nr.501, datë 31.12.2019 nga Kryetari i Bashkisë Devoll Z. E. D.. –Rregullorën “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për Mbrojtjen nga hakmarrja”, miratuar me Urdhër nr.501/1 datë 31.12.2019 nga Kryetari i Bashkisë Devoll Z. E. D..

Është bërë përgatitja dhe plotësimi i regjistrit për regjistrimin e rasteve të sinjalizimit dhe rasteve të mbrojtjes nga sinjalizimi.

- a. Është bërë njoftimi në recepsionin dhe faqen e ëëbit të Bashkisë Devoll për Njësinë e Sinjalizimit të Brendshëm.
- b. Është bërë publikimi i akteve ligjore e nënligjore për sinjalizimin në faqen zyrtare të Bashkisë Devoll.

c. U janë dërguar me postë të brendshme elektronike punonjësve të bashkisë, aktet ligjore e nënligjore të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, dokumentacionin e miratuar për sinjalizimin e brendshëm e të jashtëm si dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve.

d. Janë organizuar dhe zhvilluar trajnime, konsultime dhe sqarime nga Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm të Bashkisë Devoll me punonjësit për njohjen e ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizimiti ndryshuar me shkresat si vijon:

Shkresa me nr.589 datë 24.02.2022: Njoftim për trajnimin e punonjësve për njohjen dhe zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizimiti ndryshuar dhe njoftimit në faqen zyrtare të Bashkisë Devoll në datën 17.11.2022, proces-verbalit të mbajtur në trajnimin e zhvilluar në datë 18.11.2022 sipas njoftimit.

*Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të konstatuara, mbajnë përgjegjësi;*

1. Z. E. D., me detyrë Kryetar i Bashkisë Devoll
2. Zj. A. K., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm.
3. Z. E. S., me detyrë specialist ne Auditimin e Brendshëm

Për sa me sipër është trajtuar dhe observacioni me nr.2377/6 prot datë 23.07.2024 dhe observacioni me nr.2377/9 prot datë 25.07.2024, nga Bashkia Devoll nga Kryetari Bashkisë E. D. dhe specialistet A. K. dhe në menaxhimin dhe vlersimin e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Devoll, për sa më poshtë vijoj:

#### **Pretendimi i Subjektit:**

-Sa i përket pretendimit se në shkresën me nr.86/4 prot datë 14.02.2024 është dërguar Memorandum për vlersimin e punës së kryer për vitin 2023 “ Misjonin e auditimit tematik Janar –Mars ” mbi vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga auditimi i brendshëm gjatë vitit të mëparshëm në Bashkinë Devoll “Trajtuar me gjatë në faqen 78 të Projekt-Raportit ” të auditimit si dhe shkresa me nr. 86/5 prot date 29.03.2024 të dërguar MFE Drejtorise së Përgjithshme të Harmonizimit të kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik për vitin 2023 rrezulton se:

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

-Sa i përket observacionin të paraqitur nga subjekti i audituar, sqarojmë se administrimi i dokumentave të paraqitura nga ana juaj janë paraqitur ne Projejt-Raport auditimi janë paraqitur në rekomandimet e dhëna në vitin 2023 si dhe masat e mara.

Në Sektori i Auditit të Brendshem ka funksjonuar me mungesë personeli ne vitin 2023 pretendimi i juaj qëndron, por nuk justifikon mangësitë dhe menaxhim me të mirrë të rekomandimeve të vitit 2023 të cilat në shume raste janë kostatuse, të persëritura dhe në vitet e mëparshme, pa efekshmeri dhe pa lenë detyra konkrete, esecile dhe ligjore për secilen drejtori, të permendura në kontrollin tematik të zbatimit të rekomandimeve të lëna në “ Misjonin e auditimit tematik Janar –Mars ” të cilat nuk i kanë zbatuar një pjese të rekomandimeve të lena nga ana juaj .

-Në observacionin e paraqitur nuk janë kryer auditimin përfundimtar të vitit 2023 në vitin 2024 dhe në observacion nuk keni paraqitur as një dokument verifikimi, në përputhshmëri sipas ligjit, pra oservacioni i juaj nuk qendron.

## **2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.**

*2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2023;*

*2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;*

*2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.*

*2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe*

datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

### **2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023.**

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2023 për përgatitjen e PBA 2024-2026 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.50, datë 31.07.2023, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.2469 prot., datë 11.08.2023. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Devoll.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Infrastruktura rrugore;*
- b. *Strehim social;*
- c. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
- d. *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin;*
- e. *Shërbime publike vendore;*
- f. *Investime në përmirësimin e strukturave të shërbimeve komunitare.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisve të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2023 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.95, datë 30.11.2023 e konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Korçë me shkresën Nr.1043/1 datë 13.12.2023.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Devoll i planifikuar për vitin për vitin 2023 është 648,890, mijë lekë dhe realizuar 506,116.67 mijë lekë ose 78% me një diferencë 142,774 mijë lekë. Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2023, realizohen nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgoohen;

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Nr	Kodi	Emërtimi	PBA 2023	Buxheti Vjetor 2023(Plani i rishikuar)	Diferenca
			1	2	(1-2)
1	1110	Planifikim Menaxhim Administrim	80,201.0	88,005.05	(7,804.05)
2	3140	Sherbimet e Policise Vendore	8,319.0	10,165.99	(1,846.99)
3	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	18,080.0	30,311.58	(12,231.58)
4	4220	Buqesia	2,403.0	7,525.34	(5,122.34)
5	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	22,135.0	24,773.30	(2,638.30)
6	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	10,230.0	12,638.96	(2,408.96)
7	4520	Rrjeti rrugor rural	82,531.0	90,373.43	(7,842.43)
8	5100	Menaxhimi i mbetjeve	37,182.0	53,448.45	(16,266.45)
9	6140	Zhvillimi I strehimit	12,633.0	10,443.20	2,189.80
10	6190	Strehimi	0	6,415.36	(6,415.36)
11	6260	Shërbimet publike vendore	72,595.0	112,939.92	(40,344.92)
12	6330	Ujesjelles Kanalizime	0	117.59	(117.59)
13	8130	Zhvillimi i Sportit	10,720.0	18,626.50	(7,906.50)
14	8220	Trashëgimia kulturore, evente artistike..(P.Kultur)	16,988.0	33,454.93	(16,466.93)
15	9120	Arsimi baze perfshire Arsimin parashkollor	101,653.0	111,587.38	(9,934.38)
16	9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	6,445.0	9,996.54	(3,551.54)
17	10140	Kujdesi social për femijet (Çerdhja)	0	0	0
18	10430	Kujdesi social për person e semure dhe me aftesi te kufizuar	12,141.0	28,066.57	(15,925.57)
19	10910	Emergjencat Civile	0	0	0
<b>Totali i Shpenzimeve te Njesise</b>			<b>494,256.0</b>	<b>648,890.09</b>	<b>(154,634.09)</b>

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024 ne zërat për shpenzimet e institucionit, pjesë e të cilit është rishikuar dhe planifikimi vitin buxhetor 2023, duke mos analizuar sipas zerave të ardhurat me shpenzimet dhe duke i shtuar ato ne vlerën 154,634 mijë lekë.

Pra kemi të ardhura faktike në vitin 2023 të rakorduara me thesarin në vlerën 506,116 mijë lekë dhe shpenzimet ne vitin 2023 të rishikuara 648,890 mije lekë pra rritur shpenzimet në vleren **142,774 mijë lekë** pa marrë parasysh historikun e viteve të mëparshme.

Nisur dhe nga krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor te vitit 2022, rezulton se plani i rishikuar ndërmjet planit fillestar duhej rishikuar dhe studjuar me kujdes dhe analizuar sipas zërave përkatës.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2022-2024 Bashkia Devoll ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në aneksin nr 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

## **2.2.Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e

deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Devoll dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Devoll ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Lezhë.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Devoll rezultoi se:

Për vitin 2023, **plani progresiv i shpenzimeve me burim financimi nga fondet për të cilat Bashkia Devoll** ka lirshmëri në përdorimin e tyre, përbëhet nga:

-Të ardhurat e trashëguara nga viti 2022 në vlerën 79,935.20 mijë lekë;

-Transfertë e pakushtëzuar në vlerën 230,605.96 mijë lekë;

-Të ardhurat e mbledhura nga taksa dhe tarifatat vendore në vlerën 130,194,17mijë lekë;

-Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (specifike) në vlerën 108,559.40 mijë lekë;

-Fondi nga transfertat në vlerën 61,434.54 mijë lekë.

-Donatorë në vlerën 2,549.91 mijë lekë

**Gjithësej fonde në dispozicion të ardhura në vlerën 613,279.18 mijë lekë.**

Sipas të dhënave të mësipërme rrezulton se planifikimi duhej bërë me konsultime me grupet e interesit, nga Bashkia Devoll ka mbajtur Raport Permbledhës mbi degjesat publike të zhvilluara në të gjitha njesitë administrative të Bashkisë Devoll për procesin e hartimit të paketës fiskale dhe buxhetit për vitin 2023 nuk na u paraqit asnjë dokument shkresor që është renë dakort për rritje tarifash në masën 20% dhe rritje tarifash 25% për biznesin e madh me grupet e interesit .

Por nisur nga të dhënat e vitit 2023 dhe të ballafaquara me të dhënat e vitit 2022 rrezulton se Raport Permbledhës mbi degjesat publike të zhvilluara në të gjitha njesitë administrative të Bashkisë Devoll për procesin e hartimit të paketës fiskale dhe buxhetit për vitin 2023, është renë dakort për rritje tarifash në masën 20% dhe rritje tarifash 25% për biznesin e madh, pra Raporti Permbledhës është formal i pa ndryshuar dhe i pa realizuar pasi në vitin 2022 realizimi i tyre ka qenë 79% dhe në vitin 2023 ka qenë 78 % në raport “ nuk ka asnjë dokument të firmosur nga grupet e interesit por vetëm nga 3 ( tre ) punonjësit e Bashkisë Devoll dhe shifrat janë të njëjta me vitin 2022, pa ndryshime” .

-Përgjatë vitit 2023 me vendim të Kryetarit të Bashkisë Devoll, buxheti ka pësuar 8 **ndryshime**<sup>4</sup> buxhetore brenda të njëjtit program buxhetor, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, si dhe me vendim të Këshillit të Bashkisë ka pësuar 8 **ndryshime** ndërmjet programeve buxhetore dhe te aprovuara nga Prefektura e Qarkut Korçë konkretisht:

Me VKB nr. 17 date 27.02.2023 kanë ndodhur shtesa të fondeve per shpenzimet e trasheguara nga viti 2022 në vlerën 79,935, lekë gjithsej, e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korçë me Nr.241/1 Prot. datë 13.03.2023

Me VKB nr. 22 date 30.03.2023 ka ndodhur shtesë /paksim per nje ndryshim te VKB nr.17 date 27.02.2023 per disa shtesa dhe pakesime ne paga dhe shtesa ne investime ne vleren 20,959.16 mije leke, e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korce me Nr.337/1 Prot .datë 11.04.2023.

Me VKB nr. 49 datë 31.07.2023, akordim fond inga Ministria e Financës per rritje page ne total ne vleren 8,346.384 lekë e ndare ne sig shoqerore ne vleren 7,151.90 mije leke , dhe sigurime shoqerore ne vleren 1,194.48 mije leke, e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korce me Nr.695/1Prot .datë 10.08.2023 .

Me VKB nr. 51 datë 31.07.2023, akordim fondi nga SASPAK per pagesen e TVSH-se per projektet IPA ne vleren 2,012,953 leke, e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korce me Nr.695/1Prot .datë 10.08.2023 .

Me VKB nr. 62 datë 31.07.2023, akordim fondi per efekt te rritjes se pages per arsimin dhe zjarrfikesit ne vleren 3,787,718 leke e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korce me Nr.695/1Prot .datë 10.08.2023.

Me VKB nr. 70 datë 29.09.2023, kanë ndodhur shtesa/paksim të fondeve sipas llog 231 dhe 602 ne vleren 6,826,810 leke per shtesa ne investime per vleren 2,694,225 leke , shpenzime 3,717,585 leke dhe paga ne vleren 415,000 leke.

Me VKB nr. 74 datë 27.10.2023, akordim fondi nga SASPAK per pagesen e TVSH-se per projektet IPA ne vleren 3,014,968 leke, konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korce me Nr.3652 Prot .datë 03.11.2023

Me VKB nr. 102 datë 22.12.2023, akordim fondi nga SASPAK per pagesen e TVSH-se per projektet IPA vleren 16,321,400 leke, konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korce me Nr.4321 Prot .datë 26.12.2023.

Sipas planifikimit të vitit 2023 dhe realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik 2023.

Nr	Emërtimi	Buxheti Vjetor i rishikuar 2023	Realizimi	%
1	Planifikim Menaxhim Administrim	88,005.05	70,924.33	80.59
2	Sherbimet e Policise Vendore	10,165.99	8,781.02	86.38
3	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	30,311.58	16,314.09	53.82
4	Buqesia	7,525.34	5,556.70	73.4
5	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	24,773.30	19,789.89	79.88
6	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	12,638.96	9,104.88	72.04
7	Rrjeti rrugor rural	90,373.43	79,828.65	88.33
8	Menaxhimi i mbetjeve	53,448.45	40,193.5	75.2
9	Zhvillimi I strehimit	10,443.20	9,328.08	89.32
10	Strehimi	6,415.36	5,739.95	89.47
11	Shërbimet publike vendore	112,939.92	80,422.26	71.21
12	Ujesjelles Kanalizime	117.59	117.59	100
13	Zhvillimi i Sportit	18,626.50		94.26
14	Trashëgimia kulturore,evente artistike..(P.Kultur)	33,454.93	30,315.70	90.62
15	Arsimi baze perfshire Arsimin parashkollor	111,587.38	83,879.90	75.17
16	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	9,996.54	4,303.63	43.05
17	Kujdesi social për femijet (Çerdhja)	0	0	0
18	Kujdesi social për person e semure dhe me aftesi te kufizuar	28,066.57	24,076.88	85.78
19	Emergjencat Civile	0	0	0
	<b>TOTAL</b>	<b>648,890.09</b>	<b>506,116.66</b>	<b>77.99</b>

<sup>4</sup>Pasqyruar në tabelën nr.3 Kapitulli V Anekse-Aneksi nr.1;

Burimi: Bashkia Devoll, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

**Për vitin 2023** realizimi i buxhetit është në nivelin 77.99%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është Zhvillimi i Sportit, Trashegimia Kulturore, Rrjeti rrugor, dhe zhvillimi i strehimit”; Programi me realizimin më të ulët është “Arsimi i mesëm i përgjithshë”.

### **2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;**

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Devoll, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Laç, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të KB ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se sipas urdherit me nr.87 date 07.03.2023 titullarit të Bashkisë z.E. D. , ka ngritur komisioni për pregtatitjen e buxhetit 2023 për Bashkinë Devoll të përberë nga 8 punonjes dhe të protokolluar me Nr. 802 prot.date 07.03.2023.

Nga sektorët përkatës janë ndjekur procedurat për informacion sipas sektorve përkatës që mbulon Bashkia Devoll ku pjesën më të madhe e zënë shërbimet publike vendore në vlerë 112,939.92 mijë lekë e të cilat zënë reth 17.4% nga keto janë realizuar 80,422.26 mijë leke ose 71.21% e tyre.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2022-2023, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2022

<b>Art.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Buxheti Vjetor</b>	<b>Fakti</b>	<b>%</b>
600	Paga	262,016,429.00	227,471,582.00	86.82
601	Sigurime Shoqërore	45,137,521.00	37,839,229.00	83.83
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	212,257,435.46	133,824,851.00	63.05
604	Transferta Korente të Brendshme	11,936,765.00	10,019,053.00	83.93
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,921,000.00	3,432,942.00	87.55
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	113,620,928.04	93,529,016.00	82.32
	<b>TOTAL</b>	<b>648,890,078</b>	<b>506,116,673</b>	<b>77.99</b>

Pra në grupin e punës të përbërë nga N/Kryetari, Sekretari, administratore të njësive ,drejtore sipas strukture si dhe përgjegjës sipas strukturave përkatëse të Bashkisë Devoll ku kostatohet se realizimi i shpenzimeve operative të administratës vazhdon të jetë e pandryshuar me atë të vitit 2023 janë të njësuara , nuk ka mendime nga secila drejtori dhe sektor për të analizuar secilin zë të pasqyruar në buxhetin e vitin 2022 sipas ligjit nr.9936,date 26.06.2008 të ndryshuar me ligjin nr 114/2012 datë 07.12.2012 nr.57/2016,date 02.06.2016 neni 4/1 .

Raportet e monitorimit të buxhetit janë paraqitur në çdo 4 muaj nga muaji Janar -Prill 2023 dhe është raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe konkretisht është dërguar Raporti Monitorimit si 4 muaj me Nr.1588 prot.date 29.05.2023 ,raportet e monitorimit të buxhetit në 4 muaj e dyte nga muaji Janar -Gusht 2023 dhe është raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe konkretisht është dërguar Raporti Monitorimit si 4 muaj e II me Nr.3021 prot.date 28.09.2023 ,si dhe raportet e monitorimit të buxhetit në monitorimit të vitit 2023 dhe është raportuar pranë Ministrisë së Financave dhe konkretisht është dërguar Raporti Monitorimit si vjetor me Nr.570/1 prot.date 23.02.2024.

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2,

datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44<sup>5</sup>, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezulton se për vitin 2023 raportet periodike dhe ai vjetor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, janë realizuar dhe përcjellë në Këshillin Bashkiak, si dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër, pavarësisht mos realizimit të tyre.

**2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve(Faturat e pa likujduara të shoqërohen me liste analitike, të detajuara me nr. fature dhe datë krijimi etj,sipas raportimit në MF,ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR,Ministrisë e linjës etj.).**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Devoll, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2023 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2023, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.12.2023-31.12.2023 ka ardhur duke u ulur e krahasuar me fundin e vitit 2022. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2023.

<i>Detyrimet e NJQV 2023</i>	<i>Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2022</i>	<i>Detyrimi I krijuar gjatë vitit 2023</i>	<i>Total detyrtime</i>	<i>Shlyerja gjatë 2023</i>	<i>Mbetja në fund të vitit 2023</i>
<i>a</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3=1+2</i>	<i>4</i>	<i>5=3-4</i>
<i>Investime</i>	105,414,547	37,586,391	<b>143,000,938</b>	65,346,029	77,654,909
<i>Vendime gjyqësore</i>					
<i>601</i>					
<i>602</i>	9,706,008	84,756,649	<b>94,642,657</b>	78,642,457	15,820,200
<i>Te tjera</i>	459,645	0	<b>459,645</b>	37,687	421,958
<i>Total detyrime</i>	<b>115,580,200</b>	<b>122,343,043</b>	<b>237,923,243</b>	<b>144,026,176</b>	<b>93,897,067</b>

Burimi: Bashkia Devoll, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Devoll në fund të vitit 2023 është në vlerën **93,897 mijë lekë** dhe në fund të vitit 2022 ka qene 115,580 **mijë** pra me një ulje të detyrimeve në vlerën **21,683mijë** lekë ( 115,580 mijë – 93.897 mijë lekë) krahasuar me vitin 2022

Në pasqyrat e paraqitura në monitorimin e fundit të vitit 2023 **jepen të dhenat sipas zërave të detyrimeve të palikujduara** dhe me diferenca me sipas instucioneve (shif pasqyren si më poshtë)

Detyrimet e prapambetura të raportuara në Ministrinë e Financës në vitin -2022-2023

**/lekë**

Nr.	Detyrimet e Njesise Qeverisjes Vendore Devoll	Totali i detyrimeve deri në fund të vitit 2022	Totali i detyrimeve deri në fund të vitit 2023	Rritja / ulja në vitin 2023
1	Energj	459,645	421,958	-37,687
2	Ujsjellës			

<sup>5</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

3	Poste			
4	Sigurime shoqërore			
5	Investime	105,414,547	77,654,909	-27,759,638
6	Vendime gjygjësore			
7	Mallra	6,707,420	12,002,514	+5,295,094
8	Sherbime	2,998,588	3,817,686	+819,098
	<b>Shuma</b>	<b>115,580,200</b>	<b>93,897,067</b>	<b>-21,683,133</b>

detyrimeve e prapambetura në krahasim me vitin 2022 kanë ardhur duke u ulur në vlerën 18,7%.

-Pra konstatohet se janë pa shlyer detyrimet në fund të vitit 2023 në shuma të mbedha të faturat e pa likujduara, në sherbime si në Energji elektrike dhe në vitin 2023 kanë dyfishuar detyrimet të cilat ngarkojnë debitin në Shumën **37,687 mijë** lekë, në fund të vitit 2023 ka qënë 21,683 mijë lekë të prapambetura në fund të vitit 2023 etj.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura e cila po trashëgohet nga viti në vit.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Devoll, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2023 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2023, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 ka ardhur duke u ulur.

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Në Bashkinë Devoll është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut ngritur me urdherin nr.87 date 07.03.2023.

-Në Bashkinë Devoll është krijuar regjistri i riskut për të cilin është informuar keshilli bashkiak me shkresën nr.2298 date 27.07.2023 .

-Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Mbetet problematike menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riksit me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.

-Në Bashkinë Devoll Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qënë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtoria e të Ardhurave ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore për familjarët por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

**Në lidhje me parimin** “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrimë”.

-Ky institucion ka bërë Vlerësimin Strategjik e Menaxhimit të Riskut për vitin 2023 , po nuk ka analize të hollësishme të riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit dhe masat që duhen marrë në të ardhmen .

**Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi:**

5. Z. E. D., kryetar i Bashkisë Devoll.

6. Znj. E. H., nën/Kryetare e Bashkisë Devoll.

7. Znj. M. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të financës/Koordinator i Riskut.

## **2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Nga informacioni i dhënë nga Bashkia Devoll rezulton se kjo Bashki nuk ka përfituar fonde nga Findi i Zvillimit të rajoneve për vitin 2023

## **3. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre**

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:**

### **➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 90, datë 20/12/2022, “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Devoll për vitin 2023”, ku përfshihet edhe struktura e drejtorisë së të ardhurave, lejeve dhe licensave, e cila përbëhet nga 12 Punonjes me përbërje 1 Drejtor, 2 përgjegjës sektori, 3 specialistë dhe 6 Inspektorë.

Struktura e Drejtorisë të Ardhurave Lokale për vitin 2023 paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

### **➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:**

**Nga auditimi rezulton se** Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Devoll parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Devoll për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur RPA të auditimit.

Për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 184,444,836 lekë dhe realizimi në vlerën 146,452,566.47 lekë ose në masën 79% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 37,992,270 lekë. Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 193,756,148 lekë dhe realizimi në vlerën 132,744,034 lekë ose në masën 69% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 61,012,114 lekë.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Devoll që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë

20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:**

**Konstatohet se** akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, ku përcaktohet se: “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura, apo i shmangët mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangu.”, UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 95, datë 31.03.2022, nuk është përfshirë personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve me agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta. Vetëm për ndjekjen e arkëtimeve dhe rakordimeve me Agjentin Tatimor, Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Devoll është parashikuar si detyrë konkretisht në nenin 120, pika 17 “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore” të rregullores së brendshme.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Devoll dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Devoll. Gjithashtu Bashkia Devoll duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë ShA. Sipas akt-rakordimet e mbajtura midis Bashkisë dhe Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë ShA janë mbajtur çdo muaj por në akt-rakordime kemi vetëm shumat e paguara sipas llojit të taksave dhe jo numrin e familjeve të cilët kanë paguar.

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

Në **Pasqyrën 3** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet nga agjentët tatimorë për vitin 2022.

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2023
UKK Korçë sh.a	Taksë ndërtese	64,352,086
	Taksë trualli	
	Taksë toke buqësore	
	tarifë pastrimi	

	tarifë ndriçimi	
	tarifë gjelbërimi	
	tarifë mirembajtje varezash	
Drejtoria e transportit Rrugor	Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura	11,401,814
Ministria e Financave	Takse mbi të ardhurat personale (T.A.P)	10,739,730
Drejtoria e tatimeve	Renta Minerare	24,055

**Burimi:** Bashkia Devoll

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

**Nga auditimi rezulton se** Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Devoll kryhet në programin Excel. Drejtoria nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon rregjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Devoll i administrohet në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistruar në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabim në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Referuar të dhënave të marra nga DTV Bashkia Devoll, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Rregjistri i biznesit Bashkia Devoll.

Nr.	Lloji i Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrimet e reja	Mbyllur Aktivitetin	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi i Vogël	2022	346	14	25	335
		2023	335	21	26	330
2	Biznesi i Madh	2022	129	6	5	130
		2023	130	1	3	128
(1+2)	Gjithsej	2022	475	20	30	465
		2023	465	22	29	458

**Burimi:** Bashkia Devoll

➤ **Ndjekja e të gjitha procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për abonentët privatë dhe familjarë.**

**Detyrimet e familjarëve:**

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensimit nuk ka hartuar rregjistrin e familjarëve sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe

tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj Në rregjistrim e mbajtur nga Bashkia Devoll gjendet si informacion vetëm lista emerore e personave të cilët duhet të ngarkohen me bazën e taksave. Rregjistrim fizik i mbajtur nga Bashkia Devoll nuk është i plotësuar sipas abonentëve për detyrimet e tyre sipas paketës fiskale dhe pagesat e kryera prej tyre.

Duke mos patur informacioni e saktë nga regjistri kjo do të sjelli edhe parashikim të gabuar për mbledhjen e taksave.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Devoll me VKB nr.90 datë 20.12.2022 ka përcaktuar si si agjent tatimor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë ShA për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për çdo familje

Për analizimin e debitorëve të Bashkisë Devoll, do të marrim në konsideratë vetëm numrin e abonentëve familjarë të cilët kanë të lidhur kontratë me UKK, për abonentë familjarë të cilët nuk kanë një kontratë me UKK nuk kemi informacion për numrin e tyre dhe pagesat që kanë kryer për vitin 2023.

Nga analizimi i paketës fiskale 2023 për Bashkinë Devoll janë përcaktuar taksat dhe tarifave vendore si mëposhtë:

1)Taksë Ndërtesë: 17.5 lek/ m<sup>2</sup>

2)Taksë Truall : 0.28 lek/ m<sup>2</sup>

3)Taksë Pastrimi: 2,400 lek/vit për familje

4)Taksë Ndriçimi: 1,800 lek/vit për familje (Bilisht) dhe 1,500 lek/vit për familje Njësitë Administrative.

5)Taksë Gjelbërimi 360 lek/vit për familje (Bilisht)

6)Mirëmbajtje Vareza 360 lek/vit për familje

7)Taksa e tokës është e ndarë në 7 kategori.

Taksat e mësipërme ngarkohen në bazë mujore nga UKK tek abonentët familjarë. Sipas aktrakordimeve mujore me UKK vlera totale për vitin 2023 e paguar nga abonentët familjarë është 64,352,086 lekë.

Nga taksat dhe tarifave vendore të përcaktuara në paketë fiskale dhe nga informacioni i përcjellë nga UKK për numrin e abonentëve familjarë kemi kryer analizën e mëposhtme për detyrimet e papaguara nga abonentët për vitin 2023.

#### **Kjo analizë është kryer me rezerva për shkak:**

1)Për sipërfaqët e ndërtesave Bashkia Devoll nuk ka informacion, edhe në paketën fiskale është parashikuar për abonentët të cilët nuk kemi informacion për sipërfaqën e ndërtesës taksa do të llogaritet për 100 m<sup>2</sup> ndërtesë.Kjo metodë taksimi mund të sjelli të ardhura të munguara për Bashkinë Devoll.

2)Për sipërfaqen e truallit Bashkia Devoll nuk ka informacion, edhe në paketën fiskale është parashikuar për abonentët të cilët nuk kemi informacion për sipërfaqën e truallit taksa do të llogaritet për 300 m<sup>2</sup> truall. Kjo metodë taksimi mund të sjelli të ardhura të munguara për Bashkinë Devoll.

3)Nga Bashkia Devoll nuk na është paraqitur informacioni për familjet e përjashtuara nga taksat dhe tarifave vendore konform legjislacionit.

4)Informacioni për taksën e tokës nuk është i plotë përshkak sepsë nuk është kryer ndarje e sipërfaqeve të tokës sipas kategorive të përcaktuara në paketën fiskale 2023.

Në **Pasqyrën 4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor 2023 si vijon:

Nr.	Për abonentët familjarë	Viti 2023		Vlera e mbledhur për vitin 2023 sipas rakordimit me URKK	Vlera debitore 2023 abonente familjarë
		Nr. Familje që kanë kontratë me UKD	Vlera e taksa sipas paketës fiskale 2023		
1	Taksa e tokës bujqësore	8125		24,000,000	
2	Taksa pastrimi	8531	2,400 lek/vit	20,474,400	
3	Taksë ndërtesë (objekt banimi)	8531	17.5 lek m <sup>2</sup> vit	14,929,250	64,352,086 15,863,278

4	Takse trualli	8531	0.28 lek m <sup>2</sup> / vit	716,604		
5	Taksë gjelbërimi Bilisht	2501	360 lek/vit	900,360		
6	Taksë ndriçimi	8531	1,800 lek/ vit Bilisht 1,500 lek/ vit Njësitë e tjera	14,076,150		
5	Mirëmbajtje vareza	8531	600 lek/ vit	5,118,600		
	<b>Total</b>			<b>80,215,364</b>	<b>64,352,086</b>	<b>15,863,278</b>

**Burimi:** Bashkia Devoll

➤ **Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese.**

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore për vitet e mëparshme nuk kemi informacion nga ana e Bashkisë Devoll dhe nuk mund të dalim më vlerë detyrimesh për abonentë familjarë. Për vitin 2023 nga analiza e mësipërme kemi analizuar me rezerva vlerën debitorë në shumën **15,863,278 lekë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Devoll**, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familiar deri në datën 31.12.2023. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

**Taksa e tokës:**

Bashkia Devoll për vitin 2023 ka parashikuar të mbledhi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 24,000,000 lekë. Nga informacioni që na është përcjellës nga Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve kemi informacion për sipërfaqen totale që ju është ndarë 8,125 familjeve konkretisht **12,835.83** ha. Realizimi i kësaj taksë për vitin 2023 është në vlerën 14,954,204 lekë ose 62.31% e totalit të parashikimit. Nga auditimi i taksës bujqësore nuk mund të shprehimi për saktësinë e parashikimit të kësaj takse sepse nuk kemi informacion për kategorizimin e tokës së ndarë dhe për të përcaktuar barrën tatimore për cdo familje që ka përfutur tokë bujqësore paraqitet në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifatat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën 14,421,928 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll. Gjendja e debitorëve të krijuar për vitin 2023 është në vlerën 2,480,171 lekë. Vlera prej 11,941,757 lekë i përket viteve të mëparshme.

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Debitore 31.12.2022	Lëvizja viti 2023		Gjendje 31.12.2023
	Shtuar	Pakësuar	
<b>BIZNESI I VOGËL</b>			

8,017,060	3,610,685	1,919,378	9,708,367
<b>BIZNESI I MADH</b>			
3,314,697	2,944,770	2,269,906	3,989,561
<b>INSTITUCIONET</b>			
610,000	114,000	-	724,000
<b>TOTAL DEBIA</b>			
<b>11,941,757</b>	<b>6,669,455</b>	<b>4,189,284</b>	<b>14,421,928</b>

**Burimi:** Bashkia Devoll

Sa më sipër dalim në konkluzionin se nga strukturat tatimore të Bashkisë Devoll, për vitin 2023 ka ndërmar në total 31 urdhër bllokimi në bankat e nivelit të dytë në vlerën 4,808,311 lekë.

INSTUTICIONI	SHKRESA		MASA BLOKIM		ZBATUAR	
	NR	DATË	NR	VLERA	NR.	VLERA
Bankat e nivelit të dytë	2781	07.09.2023	1	160,948		
	3202	10.10.2023	30	4,647,363	4	416,950

Referuar shkresave të sipër cituara Drejtoria e tatimeve nuk ka marë masa për bllokimin e logarive bankare për të gjithë debitorët, për asnjë nga subjektet nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”. Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksat e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Devoll në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 878,183 lekë për 22 persona, të cilët kanë paguar detyrimin. Për periudhën deri më 31.12.2022 nuk kanë paguar detyrimet 22 persona në vlerën **1,589,610** lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll. Në mënyrë të detajuar paraqisim listën e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet, si vijon:

Nr.	Data	Emer Mbiemer	shuma e pa likuiduar 31.12.2022	Likuiduar 2023	gjendje 31.12.2023	Banka
1	27.05.2020	S. E. B.	43,278		43,278	
2	28.05.2020	B. T. S.	18,515		18,515	
3	28.05.2020	L. T. S.	24,990		24,990	
4	24.07.2020	V. I. S.	32,270	32,270		31.10.2023
5	24/07/2020	Z. X. P.	70,368		70,368	
6	18.09/2020	M. z. K.	46,305	46,305		18.10.2023
7	23.09.2020	X. M. I.	48,213		48,213	
8	20.10.2020	Z. N. Z.	37,555		37,555	
9	20.10.2020	N. F. H.	33,443		33,443	
10	10.12.2020	N. Z.L.	40,740		40,740	
11	10.12.2020	E.S. Z.	48,983	48,983		16.10.2023
12	23.12.2020	T. O. m.	33,390		33,390	
13	23.12.2020	J. Q. B.	42,000		42,000	
14	23.12.2020	T. M. S.	41,755		41,755	
15	19.3.2020	M. r.	37,553		37,553	
16	22.02.2021	M. m. j.	38,465		38,465	
17	14.01.2021	N. A. C.	18,620		18,620	
18	16.02.2021	A. h.	101,850	101,850		20.10.2023

19	16.02.2021	J. X.	50,295	50,295		18.10.2023
20	16.02.2021	S.B.	21,403		21,403	
21	22.04.2021	P. h.	42,403		42,403	
22	19.05.2021	N. M.	55,768		55,768	
23	19.05.2021	N. M.	293,720		293,720	
24	19.05.2021	N. M.	533,960		533,960	
25	14.07.2021	B. V. D.	297,920	297,920		27.04.2023
26	19.08.2021	A. Z.	39,183		39,183	
27	19.08.2021	J. S.	33,233		33,233	
28	15.09.2021	L. P.	9,223	9,223		16.10.2023
29	26/11/2021	R. B.	41,055		41,055	
<b>Shuma papaguar deri me 31.12.2023</b>			<b>2,176,456</b>	<b>586,846</b>	<b>1,589,610</b>	

### **Burimi:**Bashkia Devoll

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Devoll për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Devoll të jetë drejtuar ASHK Dega Korçë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

### ➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me licencë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrorë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Devoll dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrorë aktivitetin 9 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Në territorin e Bashkisë Devoll janë të regjistruara 9 biznese në aktivitet në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 9 subjekte janë pajisur me autorizim 9 subjekte, nga të cilët 6 subjekte kanë paguar vlerën e plotë të licencës dhe për këto subjekte është lëshuar licencë më afat 5 vjeçar në vlerën 6,000,000 lekë ndërsa për 3 subjekte bashkia Devoll ka lidhur akt marrvëshje për likuidimin e vlerës prej 3,000,000 lekë. Deri me datë 19.07.2024 është paguar vlera prej 2,400,000 lekë dhe ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 600,000 lekë e cila konsiderohet detyrim I pa arkëtuar për buxhetin e bashkisë Devoll. Gjithashtu lidhja e këtyre aktmarrvëshjeve është në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr. 77, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pasi marrvëshje është për detyrimet e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe zgjat vetëm një vit kalendarik.

Lista e subjekteve të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre:

Nr	Subjekti	Nipt	Afati I autorizimit		Detyrimi per autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	A.sh.p.k	K.....G	06.12.2018	05.12.2023	1,000,000	1,000,000	0
2	E.	L.....O	12.01.2021	11.01.2026	1,000,000	1,000,000	0
3	K. SH.P.K	J.....P	26.02.2020	25.02.2025	1,000,000	1,000,000	0
4	O. SHPK	J.....I	17.06.2020	16.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
5	G.	L.....I	23.06.2020	22.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
6	G.	K.....T	03.11.2020	02.11.2025	1,000,000	1,000,000	0
7	R. H.	K.....Q			1,000,000	1,000,000	
8	M. SHPK	K.....F			1,000,000	800,000	200,000
9	I.	M.....D			1,000,000	600,000	400,000
	<b>Total</b>				<b>9,000,000</b>	<b>8,400,000</b>	<b>600,000</b>

**Burimi:** Bashkia Devoll

### **Konkluzion:**

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll në vlerën totale **32,474,498 lekë**.

- Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet familiare në vlerën **15,863,278 lekë**

- Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga bizneset në vlerën **14,421,928 lekë**

- Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,589,610 lekë**

- Të ardhura të munguara nga mospagimi i autorizimit së tregtimit me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre në vlerën **600,000 lekë**

Për periudhën objekt auditimi, përgjegjësi mbajnë punonjësit e mëposhtëm:

**1. z. G. H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.

**2. znj. D. R.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave.

**3. znj. V. B.** me detyrë specialiste Sektorit i Kontabilizimit të të Ardhurave.

**4. z. I. D.** me detyrë Përgjegjës Sektori i Inspektoriatit Tatimor, Kundravajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi.

**5. z. G. M.** me detyrë specialist i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

*“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”*

**4. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**4.1.** Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

**4.2.** Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

**4.3.** Opinioni mbi pasqyrat financiare.

➤ **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

➤ **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

### **Oasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit **17,095 mijë lekë**, sipas **Pasqyrës** më poshtë:

#### **PF.1: Materialiteti për Bashkinë Devoll 2023 000/Lekë**

<b>Emërtimi i Shpenzimeve 2023</b>	<b>Vlera e Popullatës</b>	<b>Faktori i Riskut (0.7-2-3)</b>	<b>Çështje për tu shqyrtuar</b>
Paga (600)	235,082,712	0.70	12
Sigurime Shoqërore (601)	34,724,428	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	134,628,697	0.70	7
Investime të brend. (230-231)	158,180,559	2.00	23
Te tjera transfer. korrente (606)	292,164,766	0.70	15
<b>Total</b>	<b>854,781,162</b>		
<i>Materialiteti në %</i>	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>17,095,623</b>		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
<b>Materialiteti</b>	<b>17,095,623</b>		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	1,709,562		
<b>Nëntotali</b>	<b>15,386,061</b>		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>13,847,455</b>		

### **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Devoll në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. A. F. me detyrë Përgjegjës I Sektorit të Menaxhimit Financiar (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Devoll me shkresën nr. 881 prot., datë 29.03.2024, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 29.03.2024.

### **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

### **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
  - Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
  - Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
  - Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
  - Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **-Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e **Pasqyrave Financiare të Bashkisë Devoll** për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Menaxhimit Financiar. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekset pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Devoll për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2023.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Devoll (pasqyrat financiare), Formatin nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

#### PF.2

<b>Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto</b>	<b>2,946,831,635</b>
Aktivet	3,110,323,017
Pasivet	-163,491,382
Aktivet Neto	2,946,831,635

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

#### PF.3

<b>Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën</b>	<b>276,323,434</b>
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	107,162,505
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	58,901,023
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	110,057,406

*Diferenca 202,500 lekë vjen si rezultat i konvertimit të pasiveve dhe paraqitet në llogarinë 478 në rubriken ‘ të tjera pasive afatshkurtra’.*

### A. AKTIVET

#### I. Aktivet Afat Shkurtra

##### 1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

#### PF.4

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	107,162,505	79,935,202	27,227,303
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>107,162,505</b>	<b>79,935,202</b>	<b>27,227,303</b>

Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2023, në vlerën 79,935,202 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 107,162,505 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 107,162,505 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 26,089,133

lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 26,089,133 lekë. Në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 49 dhe pika 50. Shkak për këtë anomali është mos njohja dhe mos zbatimi i UMF Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për pasojë

**PF.5 Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar”**

<b>Llogaria 520 ne vitin 2023</b>		
<b>I.Të trashëguara nga viti 2022</b>		Lekë
<i>Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:</i>		
<i>Granti i trashëguar</i>		65,698,697
<i>Të ardhura të trashëguara</i>		13,605,492
<i>Mjete në ruajtje të trashëguara ( llog. 466)</i>		
<i>Fonde specifike (Donatore)</i>		631,011
<i>FZHR</i>		
<b>Totali</b>		<b>79,935,202</b>
<b>II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit 2023</b>		
Granti i vitit		230,605,958
Të ardhurat e vitit		130,194,171
Donatore		2,549,905
Granti specifik		108,559,396
FZHR		
buxheti		61,434,545
<b>Tot.</b>		<b>533,343,975</b>
<b>Totali i të ardhurave (I+II)</b>		<b>613,279,177</b>
<b>III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520 gjate vitit 2023</b>		
<i>Paga sigurime (600+601)</i>		265,310,811
<i>Shpenzime operative (602)</i>		133,592,636
<i>Subvencione (603)</i>		0.00
<i>Transferime korente të brendshme (604)</i>		10,019,053
<i>Transferime korente me jashtë (605)</i>		
<i>Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)</i>		3,432,942
<i>Kredia (BKT) + Interesa për huamarje (651)</i>		
<i>Investime (231)</i>		93,411,431
<i>Të dala nga mjetet në ruajtje (466)</i>		0
<i>Transferime korente te brendshme + transferta buxhetin e vet (418,470,743 +5,975,765)</i>		0
<b>Totali</b>		<b>506,116,673</b>
<b>Gjendja debitore (Saldi) (I+II) – III =</b>		<b>107,162,505</b>

**2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

**PF.6**

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	15,245,493	9,070,032	6,175,461
32	Inventar i imët	43,655,531	43,435,164	220,367
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			0
34	Produkte			0
35	Mallra			0

36	Kafshë në rritje e majmëri			0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			0
39	Provizgjone për zhvlerësimin e inventarit (-)			0
<b>Totali</b>		<b>58,901,023</b>	<b>52,505,196</b>	<b>-6,395,827</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 58,901,023 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 15,245,493 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 43,655,531 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 6,395,827 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në Pasqyrën e Performancës Financiare në vlerën 6,395,827 lekë.

### **Procesi i inventarizimit:**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilët kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjet dhe fletë-daljet etj..

Për vitin 2023, Kryetari i Bashkisë Devoll për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Devoll dhe Njësive Administrative Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras ka nxjerrë Urdhrin nr. 569, datë 19.10.2023, për krijimin e komisionit të inventarizimit, të vlerësimit dhe asgjesimit të aktiveve me përbërje si më poshtë:

- Komisioni i inventarizimit përbëhet nga znj. M. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. E. C., znj. H. A., znj. M. K., z. F., znj. A. G. dhe znj. B. S..
- Komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga z. E. P. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A. A. dhe znj. K. M.
- Komisioni i asgjesimit të aktiveve përbëhet nga z. A. C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. K., znj. E. U..

Me shkresën nr. 81/1 prot., datë 22.01.2024, komisioni i inventarizimit ka mbajtur relacionin përfundimtar mbi realizimin e procesit të inventarizimit të Bashkisë dhe njësive administrative.

Me shkresën nr. 192 prot., datë 17.01.2024, shkresën nr. 192/1 prot., datë 23.01.2024 nga komisioni i vlerësimit janë mbajtur relacionet përkatëse për Bashkinë dhe Njësitë Administrative mbi vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit si më poshtë:

*Lekë*

Nr.	Llogaria	Proger	Miras	Hoçisht	Qendër	Bashkia + Administrata + Shkollat	Totali
1	327	55,827	91,577	1,100	26,039	1,209,153	1,359,793
2	218	180,000	234,929	147,425	800,667	1,087,592	2,668,821
3	214	0	160,914	16,800	8,400	2,624,646	2,793,960
<b>Totali</b>		<b>235,827</b>	<b>487,420</b>	<b>535,974</b>	<b>156,925</b>	<b>4,921,391</b>	<b>6,822,574</b>

Me shkresën nr. 279/1 prot., datë 26.01.2024, komisioni i asgjesimit ka mbajtur proces verbal mbi përfundimin e procesit të asgjesimit të aktiveve në të cilën është kryer seleksionimi i materialeve

metalike nga ato jo metalike për të ndjekur procedurën e shitjes për skrap me ankand. Sasia e hekurit e seleksionuar sipas bashkisë dhe njësive administrative paraqitet si më poshtë:

#### PF.7

Bashkia dhe Njësia Administrative	Sasia/Kg
Njësia Administrative Miras	13.9
Njësia Administrative Proger	12.6
Njësia Administrative Hociisht	35.2
Njësia Administrative Qendër Bilisht	232.7
Administrata Bilisht	246.2
Shkollat Bilisht	4.4
<b>Totali</b>	<b>581</b>

Me shkresën nr. 279/1 prot., datë 26.01.2024, nga komisioni i asgjësimit është mbajtur proces verbal i nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit. Në këtë proces verbal citohet se: “Në datën 16.01.2023, përfundoi procesi i asgjësimit të materialeve jashtë përdorimit dhe u bë dorëzimi i dokumentave dhe materialeve me nr. 279 prot., datë 26.01.2024, Sektorit të Menaxhimit Financiar. Ky komision u ngrit me urdhër të Kryetarit nr. 569, datë 02.11.2023, i përbërë nga tre anëtarë. Pasi komisioni ka bërë verifikimin e aktiveve të përdorura për asgjësimin nga komisioni i vlerësimit ngritur me po të njëjtin urdhër dhe nga personat për asgjësimin nga komisioni i vlerësimit ngritur me po të njëjtin urdhër dhe nga personi përgjegjës është kryer asgjësimi i të gjitha materialeve duke gruposur ose djegur materialeve sipas rasteve për çdo njësi administrative ndërsa materiale metalik është veçuar nga pjesët e tjera për t’u shitur për skrap”.

-Referuar relacionit të sipërcituar, vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion i shoqëruar dhe me fotografi mënyra e asgjësimit, targa e mjetit të transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

-Procesi i ankandit për shitjen e skrapit deri më datën 19.07.2024, që i përket fundit të periudhës së fazës së auditimit në terren ende nuk është realizuar.

### 3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

#### PF.8

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>110,057,406</b>	<b>126,090,792</b>	<b>16,033,386</b>
411	Klientë e llogari te ngjashme			0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	859,832	859,832	0
431	Tatime e taksa			0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			0
435	Sigurime Shoqërore			0
436	Sigurime Shëndetësore			0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			0
44	Institucione të tjera publike			0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes			0
468	Debitorë te ndryshëm	66,664,236	66,670,236	(6,000)
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	42,533,338	58,560,724	(16,027,386)
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit			0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			0
	<b>Totali</b>	<b>110,057,406</b>	<b>126,090,972</b>	<b>(16,033,386)</b>
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>			
409	Parapagime	0	0	00
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin	0		0

477	Diferenca konvertimi aktive	202,500	170,000	32,5000
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2023, në vlerën 66,670,236 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 66,664,236 lekë me një zbritje në vlerën 6,000 lekë. Në mënyrë të përmbledhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2023		66,670,236
Pakësuar (D)		6,000
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>66,664,236</b>

**Konstatimi nr.1** Nga auditimi i pasqyrave financiare, në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 58,553,508 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifrat vendore të biznesit, familjarë dhe detyrime kontraktuale, më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të programit të auditimit. Për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. **Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.** Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit.

Në kundërshtim me, Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

**Konstatimi nr.2** Nga auditimi I pasqyrave financiare, **Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 42,533,338 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. U konstatua se: ka diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit, në shumën -88,562,310 lekë. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilancin kontabël është pasqyruar në mënyrë jo të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

Vlera prej 131,095,648 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Emërtimi i llogarive	Vlera	Lekë
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”		99,212,495
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”		4,413,389
Paga personeli llogaria 42		17,227,154
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431		4,672,394
Sigurime shoqërore llogaria 435		4,897,267
Sigurime shëndetësore 436		672,949
<b>Totali</b>		<b>131,095,648</b>

Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5. Në kundërshtim me pikën 32, kreu III “Procedurat për Përgatitjen, Paraqitjen dhe Konsolidimin e Pasqyrave Financiare në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 ku përcaktohet se: *Kërkesat për arkëtim mbi debitorët si dhe detyrimet të paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën e evidentuar në kohën e lindjes të së drejtës dhe detyrimit. Në zbatim të nenit 61 të Ligjit të Buxhetit, lidhur më njohjen e të ardhurave*

dhe shpenzimeve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet, në fund të periudhës raportuese duhet të paraqiten në kontabilitet, si më poshtë:

- Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

**Llogaria 477 “Diferenca konvertimi aktive”**, ka vlerën 202,500 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Lekë**

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	170,000
Shtesa (K)	32,500
Pakësime (D)	0
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>	<b>202,500</b>

**Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë. Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 0 lekë kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1.

## II. AKTIVET AFATGJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

### PF.9

Llog.Konta bel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2023	Shtesa 2023	Pakësim/amortizim 2023	Gjendje në fund
	<b>I.Aktive afatgjata</b>	<b>2,477,582,804</b>			<b>2,622,248,845</b>
<b>20</b>	<b>II. Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>56,389,661</b>	<b>0</b>	<b>2,819,483</b>	<b>53,570,178</b>
210	Toka ,troje, Terrene	3,228,553	0	0	3,228,553
211	Pyje, Kullota Plantacione	2,070,933	399,117	0	2,470,050
212	Ndërtesa e Konstruksione	530,130,804	58,259,143	26,506,540	561,883,407
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,852,219,355	204,210,581	92,610,968	1,963,818,968
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	7,882,505	2,238,150	3,723,669	6,396,986
215	Mjete transporti	71,021,035	5,678,000	2,734,185	73,964,850
216	Rezerva shtetërore	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	11,029,619	3,932,764	4,476,351	10,486,032
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0	0
<b>25-26</b>	<b>3. Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0	0
<b>Total (I+II)</b>		<b>2,533,972,465</b>	<b>247,717,755</b>	<b>127,612,735</b>	<b>2,675,819,023</b>

### 1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

-**Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 56,389,661lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim

i akumuluar në vlerën 2,819,661 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 53,570,178 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	64,348,976
	2	Amortizim i akumuluar	10,778,798
	<b>3</b>	<b>Gjendja në 01.01.2023 Neto</b>	<b>56,389,661</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	2,819,483
	<b>6</b>	<b>Gjendja neto më datë 31.12.2023</b>	<b>53,570,178</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

**Konstatimi Nr.3 :** Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se: në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë përfshirë 3 (tre) projekte “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën **1,562,000 lekë**, Ndertim ujësjellësi të jashtëm dhe të brendshëm, NJA Miras në vlerën **6,887,520 lekë**, Projektim Ujësjetës i brendshëm në NJA Miras, nga E. në vlerë **6,960,000 lekë** (kosto historike). Këto projekte nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin janë hartuar këto projekte ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Veprime të cilat kanë ardhur për shkak të mos njohjes së akteve ligjore e nënligjore për raportimin financiar, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

Për pasojë ka sjellë pasqyrim të pasaktë të kësaj llogarie, ulje të vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstrukione” dhe llogarinë 213 “ rrugë rrjete e vepra ujore”

## **2. Aktivet Afatgjata Materiale**

Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë pandryshuar nga vitit paraardhës. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF, si më poshtë:

**Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 3,228,553 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,228,553 lekë.

			Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,228,553
	2	Amortizim i akumuluar	0
	<b>3</b>	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>3,228,553</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	3,228,553
	5	Amortizim i akumuluar	0
	<b>6</b>	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>3,228,553</b>

Burimi: Bashkia Devoll

**-Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”** në datën 01.01.2023, paraqitet në vlerën neto 2,070,933 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2023 është shtuar vlera prej 399,117 lekë (Blerje pemësh) nga viti ushtrimor paraardhës. Vlera e amortizimit e akumuluar paraqitet në vlerë neto 0 lekë në fund të vitit 2023. Gjendja e kësaj llogarie është paraqitur në pasqyrën, si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,070,933
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>2,070,933</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	399,117
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	2,470,050
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>2,470,050</b>

**-Llogaria 212 “Ndërtim konstruksione”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën neto 530,130,804 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 58,259,143 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 26,506,540 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 561,883,407 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në anekse bashkëlidhur aktkonstatimit:

Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtim Konstruksione”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	709,388,445
	2	Amortizim i akumuluar	179,257,641
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>530,130,804</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	58,259,143
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	26,506,540
	4	Kosto historike	<b>767,647,588</b>
	5	Amortizim i akumuluar	205,764,181
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>561,883,407</b>

#### **Konstatimi nr.4.**

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se: Në gjendjen e llogarisë **212 “Ndërtesa e konstruksione”** në vlerë 767,647,588 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 94,936,727 lekë (47,488,945 lekë nga ish-Komuna Qendër Bilisht + 47,447,782 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Qendër Bilisht dhe Hoçisht e paanalizuar. Këto vlera ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

**-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 2,404,624,620 lekë kosto historike. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 204,210,581 lekë (ujësjellësi i NJA Miras) dhe pakësime për llogaritje amortizim i akumuluar në vlerën 645,016,233 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,963,818,968 lekë neto. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneks bashkëlidhur aktkonstatimit.

Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,404,624,620
	2	Amortizim i akumuluar	552,405,265
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>1,852,219,355</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	204,210,581
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0

	4	Kosto historike	2,608,835,201
	5	Amortizim i akumuluar	645,016,233
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>1,963,818,968</b>

Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,404,624,620 lekë kosto historike në çelje të vitit 2023 dhe në vlerë 2,608,835,201 në mbyllje të vitit ushtrimor është përfshirë vlera 572,125,235 lekë (57,441 lekë nga ish-Komuna Miras + 338,481,513 lekë ish-Komuna Qendër + 233,586,281 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilancet e ish-Komunës Miras, Qendër dhe Hoçisht. Për pasojë kjo mangësi ka ndikuar në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Për sa më sipër llogaria ekonomike **213 “Rrugë rrjete dhe vepra ujore”** dhe llogaria **212 “Ndërtesa e konstruksione”** nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2023 me ndikim në vlerat e paraqitura në bilancin kontabël.

Veprimet dhe mos veprimet janë në kundërshtime me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Znj.A. F. në cilësinë e nëpunësit Zbatues dhe hartues i bilancit kontabël.*

**-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 19,771,830 lekë kosto historike. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 2,238,150 lekë dhe pakësim në vlerën 2,683,960 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimi. Amortizim të akumuluar në vlerën 12,929,034 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,396,986 lekë në vlerë neto.

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	19,771,830
	2	Amortizim i akumuluar	11,889,325
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>7,882,505</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	2,238,150
	5	Amortizim i shtesës	1,039,709
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	2,683,960
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	19,771,830
	5	Amortizim i akumuluar	12,929,034
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>6,396,986</b>

*Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.*

**-Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 99,781,083 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 5,678,000 lekë blerje me pagesë për tre automjete. Amortizim të akumuluar në vlerën 31,494,233 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja neto e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 73,964,850. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti”	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	99,781,083
	2	Amortizim i akumuluar	28,760,048
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>71,021,035</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	5,678,000
	5	Amortizim i shtesës	2,734,185
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	105,459,083
	5	Amortizim i akumuluar	31,494,233

	6	Gjendja më datë 31.12.2023	73,964,850
--	---	----------------------------	------------

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 215 “Mjete transporti” për vitin ushtrimor 2023 është përlllogaritur në rregull norma e amortizimit. Veprime këto në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 73,657,988 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesë në vlerën 3,932,764 lekë. Pakësim në vlerë 2,574,501 vlerë historik lekë si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe amortizim i akumuluar në vlerën 64,530,219 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,486,032 lekë vlerë neto.

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	73,657,988
	2	Amortizim i akumuluar	62,628,369
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>11,029,619</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	3,932,764
	5	Amortizim i shtesës	1,901,850
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	2,574,501
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	75,016,251
	5	Amortizim i akumuluar	64,530,219
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>10,486,032</b>

## **Konstatimi nr.5**

### **3. Aktivet Afatgjata Financiare:**

Aktivët Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 0 lekë dhe kjo vlerë nuk kuadron dhe rakordon me vlerën e pasqyruar në PF dhe raportin e nxjerrë në sistemin e thesarit e cila ka vlerën 221,410,000 lekë.

Nga analiza e llogarisë 26 “Aktive afatgjata financiare”, rezulton se në çelje të vitit ushtrimor Bashkia Devoll, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 7.76% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A me NUIS M.....N, me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 7,762 mijë lekë e cila nuk është paraqitur në aktivët afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022 dhe 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivët Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 te SNK 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapirtit Përfundimtar të Auditimit).

### **4. Investimet.**

**-Llogaria 230 “Për aktivët afatgjata jo materiale”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 8,095,000 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 230 “Për aktivët afatgjata jo materiale”	
Gjendje në 01.01.2023	8,095,000
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>	<b>8,095,000</b>

**-Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 232,648,060 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 318,609,781 lekë dhe pakësime në vlerën 322,391,326 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 150,085,559 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

<b>Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”</b>		<b>Lekë</b>
Gjendje në 01.01.2023		146,304,014
Shtesa (K)		318,609,781
Pakësime (D)		322,391,326
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>		<b>150,085,559</b>

Burimi i të dhënave: *Bashkia Devoll.*

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Gjendje 31.12.2023</b>
1	Shkolla Myrteza Sala	93,634,704
2	Permiresimi	9,159,463
3	Rruget Poncare	1,450,440
4	Rruget Bitincke	1,011,120
5	Mbikqyrjerruget e qytetit	724,428
6	Rruget Bilisht 2	41,565,995
7	Investime 2007	2,539,409
	<b>Shuma në lekë</b>	<b>150,085,559</b>

### **Konstatimi nr.6**

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se : Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 150,085,559 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 2,539,409 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Veprime Në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”. Kjo vjen si pasojë e mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi dhe sjell mos kuadrim të llogarive kontabile.

## **B. PASIVET (DETYRIMET)**

### **I. Pasivet Afatshkurtra**

#### **1. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Devoll më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

#### **PF.10**

<b>Llogaria</b>	<b>Emërtimi i llogarisë</b>	<b>Viti 2023</b>	<b>Viti 2022</b>	<b>Diferenca/Ndryshimi</b>
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	99,212,495	144,568,207	45,355,712
42	Detyrime ndaj personelit	17,227,154	15,536,499	-1,690,655
16,17,18	Hua afat shkurtra			
460	Huadhënës			
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	4,672,394	4,705,731	33,337
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal			
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore			
435	Sigurime shoqërore	4,897,267	4,605,392	-291,875
436	Sigurime shëndetësore	672,949	632,794	-40,155
437,438	Organizma të tjerë shtetërore		0	
44	Institucione të tjera publike			

45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike			
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë			
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	26,089,133	20,627,875	-5,461,258
467	Kreditorë të ndryshëm	4,413,389	4,524,882	111,493
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	6,104,101	6,104,101	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
<b>Gjendje në fund të periudhës</b>		<b>163,288,882</b>	<b>201,305,481</b>	<b>38,016,598</b>

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 99,212,495 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,672,394 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,897,267 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 672,949 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 4,524,882 lekë ku totali shkon në vlerën 174,573,505 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 42,533,338 lekë, në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 17,227,154 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”		Lekë
Çelje e vitit 2023		15,536,499
Shtesa (K)		1,690,655
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>17,227,154</b>

Vlera e kontabilizuar në llogarinë “Detyrime ndaj personelit” është 17,227,154 lekë ndërkohë që duke u bazuar në dokumentacionin justifikues (urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Devoll) është në vlerën 17,227,154 dhe rakordon me urdhërshpenzimet e muajit Janar të vitit 2024.

**-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 4,672,394 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”		Lekë
Çelje e vitit 2023		4,705,731
Shtesa (K)		-
Pakësime (D)		33,337
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>4,672,394</b>

**-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 4,897,267 lekë dhe 672,949 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”		Lekë
Çelje e vitit 2023		4,605,392
Shtesa (K)		291,875
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>4,897,267</b>
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”		Lekë
Çelje e vitit 2023		632,794
Shtesa (K)		40,155
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>679,949</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

**-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 26,089,133 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%, garanci punimesh.

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2023	20,627,875
Shtesa (K)	5,461,258
Pakësime (D)	-
<b>Gjendja debitoare në 31.12.2022</b>	<b>5,461,258</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll

Në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

**PF.11**

Llogaria .466 (Kreditorë për mjete në ruajtje)		
Pershkrimi	Kredia /Lekë	Viti
Permiresimi U kushteve te banim.per komunitete te pafavorizuara	1,023,182	2021
Permiresimi U kushteve te banim.per komunitete te pafavorizuara	1,376,278	2022
Pellgu ujembledhes Bilisht	1,268,469	2020-2021
Ujesjellesi Miras	10,510,547	Vazhdon
Ujesjellesi Hocisht	3,972,678	2023
Rehabilitim rruga Bilisht-Vernik	1,396,557	2022-2023
Rikonstruksion shkolla Myrteza Sala	4,650,843	2022-2023
Fshati TREN	28,166	2021-2022
G.D Rruga Cangonj	619,940	2015
G.D Rruga e Kucit	93,023	2015
G.D Ura tip Baily	185,145	2018/2019
G.D Kanali Bracanj - Trestenik	386,627	2017
Permiresimi U kushteve te banim.per komunitete te pafavorizuara	454,600	2023
Rehabilitim I Rrugeve te fshatit Poncare Loti II	72,522	2023
Rehabilitim I Rrugeve te fshatit Bitincke Loti III	50,556	2023
<b>Gjendje ne 31.12.2023</b>	<b>26,089,133</b>	

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se: Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,307,917 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Devoll, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,461,258 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Viti	Vlera
1	Përmirësimi i banesave	2021	1,023,182
2	G. D. Rruga Cangonj	2015	619,940
3	G. D. Rruga e Kuçit	2015	93,023
4	G. D. Ura Tip Baily	2018-2019	185,145
5	G. D. Kanali Bracanj-Trstenik	2017	386,627
<b>Totali</b>			<b>2,307,917</b>

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

**-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 në PF paraqiten në vlerën 4,413,389 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në vlerë 390,951 lekë. Shumë e cila nuk duhej të paraqitej në llogarinë 401-408 por duhej paraqitur te llogaria 467 “kreditorë të ndryshëm”. Lista e kreditorëve të cilët janë keqklasifikuar paraqitet si më poshtë:

**PF.12 Lekë**

Nr.	Fatura /viti	Emertimi	Gjendje me 31.12.2023
1	2006	K. shpk	36,696
2	2006	S. N.	49,250
3	2008	T.shpk	19,700
4	2008	K. H.	7,500
5	2008	B.	4,050
6	2008	H. P.	10,880
7	2008	B. N.	1,000
8	2008	A. C.	3,300
9	2015	P.	10,200
10	2015	E. M.	8,430
11	2015	A. C.	10,055
12	2015	I. S.	8,000
13	2015	S. shpk	13,646
14	2015	A. C.	100
15	2015	U. K.	8,040
16	2015	A	5,104
17		P.shpk	170,000
	<b>Totali</b>		<b>390,951</b>

**TË ARDHURAT**

**1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:**

**-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 76,423,044 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 79,629,532 lekë me një rritje në vlerën 3,206,488 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

**2. Të ardhurat jo tatimore:**

**PF.13**

70	<i>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</i>	79,629,532	76,423,044
<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>166,769</b>	<b>64,925</b>
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	166,769	64,925
7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>17,866,556</b>	<b>16,679,310</b>
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	17,502,135	15,635,246
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme	65,707	501,495
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	298,714	542,569
<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>61,596,208</b>	<b>59,662,009</b>
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	13,001,814	11,294,479
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	48,594,394	48,367,530
<b>704</b>	<b>4.Takse mbi tregtine dhe transakcionet nderkombtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7040	Takse doganore per mallrat e importit		

7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
<b>705</b>	<b>5.Takse e rruges</b>		
<b>708</b>	<b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare</b>		<b>16,800</b>
<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>		

-Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 47,960,017 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 39,800,812 lekë me një pakësim në vlerën 8,159,205 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

#### PF.14

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
<b>71</b>	<b>III. TË ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>39,800,812</b>	<b>47,960,017</b>
<b>710</b>	<b>1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>1,832,628</b>	<b>2,085,556</b>
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	1,832,628	2,085,556
<b>711</b>	<b>2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare</b>	<b>37,968,184</b>	<b>45,874,461</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	30,810,414	29,759,864
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,631,880	2,300,591
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	73,000	118,000
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	5,452,890	13,696,006
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
<b>719</b>	<b>3. Të tjera të ardhura jo tatimore</b>		

#### 3. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 895,253,472 lekë ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 976,427,197 lekë me një rritje në vlerën 81,173,725 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

#### PF.15

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
<b>72</b>	<b>V. GRANTE KORENTE</b>	976,427,197	895,253,472
<b>720</b>	<b>1. Grant korent i brendshëm</b>	976,427,197	895,253,472
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	920,580,169	733,231,149
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)		395,000
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	10,763,785	8,439,404
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
+-7206	Financim i pritshëm nga buxheti	42,533,338	139,952,817
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	2,549,905	13,235,102
7209	Të tjera grante korente të brendshme		
<b>721</b>	<b>2. Grant korent i huaj</b>	0	0
	Nga Qeveri të huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

#### SHPENZIMET

##### 1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 207,597,349 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 235,082,712 lekë

me një rritje në vlerën 27,485,363 lekë, si pasojë e rritjes së pagave bazuar në VKM nr.328 datë 31.05.2023.

**-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 34,464,586 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 38,659,839 lekë me rritje në vlerën 4,195,253 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Devoll me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë	
<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>		<b>38,659,839</b>	<b>34,464,586</b>
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore		34,724,428	30,956,555
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		3,935,411	3,508,031

## 2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

**-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 155,600,391 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 134,628,697 lekë me zbritje në vlerën 20,971,694 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Devoll me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

### PF.16

			Lekë	
<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>		<b>134,628,697</b>	<b>155,600,391</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera			
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme		4,881,360	8,641,560
6021	Materiale dhe sherbime speciale		18,181,896	20,410,774
6022	Sherbime nga te trete		69,709,150	87,863,966
6023	Shpenzime transporti		34,786,996	28,265,093
6024	Shpenzime udhetimi		159,170	185,380
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme			
6026	Shpenzime per qeramarrje		608,000	475,806
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		69,275	1,225,452
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua			
6029	Shpenzime te tjera operative		6,232,850	8,532,360

## 3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Devoll nuk ka pasur subvencione.

## 4. Transferime korrente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korrente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 11,419,310 lekë e cila nuk rakordon me akt rakordimin e Thesarit. Në aktrakordimin e thesarit vlera e kësaj llogarie paraqitet në shmën 11,400,257 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar (11,419,310-11,400,257) 19,053 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 292,164,766 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

### PF.17

			Lekë	
<b>Llogaria</b>	<b>Emërtimi</b>		<b>31.12.2023</b>	<b>31.12.2022</b>
	<b>V. TRANSFERIME KORENTE</b>		<b>303,565,023</b>	<b>308,686,393</b>
<b>604</b>	<b>1. Transferta korrente të brendshme</b>		<b>11,419,310</b>	<b>25,077,691</b>
6040	Transferime korrente tek nivele tjera të Qeverisë		1,419,310	14,177,691
6041	Transferime korrente tek institucione qeveritare të ndryshme			
6042	Transferime korrente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore			
6044	Transferime korrente tek organizata jo fitimprurëse		10,000,000	10,900,000
<b>605</b>	<b>2. Transferime korrente me jashtë</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare			
6052	Transferime për qeveritë e huaja			

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja		
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit		
<b>606</b>	<b>3. Transferime për buxhetet familjare e individë</b>	<b>291,164,766</b>	<b>283,608,702</b>
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	23,796,000	167,292
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	267,368,766	283,441,410

**Për vitin 2023** totali i të ardhurave në vlerë është 1,095,857,541 lekë dhe totali shpenzimeve është 988,695,036 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 107,162,505 lekë kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 107,162,505 lekë.

### **Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. ***Pjesë përbërëse e akt-konstatimit janë dhe anekset bashkëlidhur.***

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për periudhën 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023 ngarkohen me përgjegjësi: z. E. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues si dhe znj. A. F. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën nga 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023.*

### **5. Auditimi mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet, Kullotat) të transferuara me VKM.**

#### **Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Devoll**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: për vitin 2023 struktura organizative është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Devoll nr. 91 datë, 20/12/2022 ku dhe është krijuar struktura e menaxhimit të asetëve. Referuar VKM –së nr.28., datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpuniminndërmjet institucioneve – ASHK. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Bashkia Devoll nuk ka krijuar komisionit e përbashkët në zbatim të VKM së sipërcituar pasi kërkohet dhe një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit me qëllim inventarizimin dhe regjistrimin dhe përditësimin e inventarve, si më poshtë vijon:

**Ish Komunës Hoçisht sot Njësia Administrative Hoçisht të Bashkisë Devoll**, me VKM nr. 17, datë 9. 1. 2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Hoçisht, të Qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit me 568 prona nga të cilat 0 prona në pronësi dhe 568 prona në përdorim. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 568 (pesëqind e gjashtëdhjet e tetë).

**Ish Komunës Progër sot Njësia Administrative Progër të Bashkisë Devoll**, me VKM nr. 24, datë 14. 1. 2009 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Progër, të Qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit me 453 prona nga të cilat 420 prona në pronësi dhe 33 prona në përdorim. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 453 (katërqind e pesëdhjet e tre).

**Ish Bashkia Bilisht sot Njësia Administrative Bilisht të Bashkisë Devoll**, me VKM nr. 764, datë 7. 11. 2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Bilisht, të Qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit me 386 prona nga të cilat 370 prona në pronësi dhe 16 prona në përdorim. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 386 (treqind e tetëdhjet e gjashtë).

-Me VKM nr. 36, datë 27. 1. 2021 “Disa ndryshime në vendimin nr. 764, datë 7. 11. 2012 i është miratuar lista inventarit me 2 prona nga të cilat 2 prona në pronësi.

-Me VKM nr. 366, datë 18. 5. 2016 i është miratuar lista inventarit me 1 prona nga të cilat 1 prona në pronësi.

**Ish Komunës Qendër Bilisht sot Njësia Administrative Qendër Bilisht të Bashkisë Devoll**, me VKM nr. 202, datë 13.03.2013 “Miratimin e listës parapake të pronave të paluajtshme shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Bilisht, të Qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit me 639 prona nga të cilat 608 prona në pronësi dhe 31 prona në përdorim. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 639 (gjashtëqind e tridhjet e nëntë).

**Ish Komunës Miras sot Njësia Administrative Miras të Bashkisë Devoll**, me VKM nr. 762, datë 28. 5. 2008 “Miratimin e listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunen Miras, të Qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit me 936 prona nga të cilat 936 prona në përdorim. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 936 (nëntëqind e tridhjet e gjashtë).

-Me VKM nr. 15, datë 13. 1. 2022 “Transferimin, ne pronesi të Bashkise Devoll, të njësisë administrative Miras, të pasurive 408/1 dhe 408/2 me vendodhje ne zonen kadastrale 3129”, i është miratuar lista inventarit me 2 prona nga të cilat 2 prona në pronësi.

**Shënim: Mungojnë VKB-të nga Këshilli Bashkiak për arsye se ka kaluar periudha 10 vjeçare dhe janë dorëzuar në Arkivin Shtetëror.**

-Lista e pyjeve dhe kullotave është transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish komunave/bashkive” i është miratuar lista inventarit me 486 prona në pronësi të bashkisë Devoll sipas stajcës nr. 37

Sa më sipër rezulton se përse i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Devoll; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Korçë, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.” dhe pika 35/a ku citohet: “Dokumentet

vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.” si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi z. E. R. me detyrë përgjegjësi i sektorit të aseteve.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Në Pronësi	Në Përdorim	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2023	Nr. Praktikave të Certifikuara 2023	Prona të pa Rregjistruara
1	Bashkia Bilisht	389	373	16	33	0	356
2	NJA. Miras	938	2	936	5	2	931
3	NJA. Hoçisht	568		568	3	0	565
4	NJA. Progër	453	420	33	12	0	441
5	NJA. Qendër Bilisht	639	608	31	21	0	618
	Total	2,987	1,403	1,596	74	2	2,911

Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë regjistruar në ASHK për periudhën deri me 31.12. 2023 paraqiten në aneksin nr. 1 pika 5 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Devoll.**

Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, konstatohet se, Bashkia Devoll ka lidhur 8 kontrata të reja si dhe ka vazhduar me rinovimin e afatit të 13 kontratave të mëparshme. Në total për 6 njësitë administrative janë aktive 21 kontrata për vitin 2023 në vlerën 5,819,796 lekë nga të cilat janë likuiduar 16 kontrata në vlerën 2,100,556 lekë duke ngelur pa u arkëtuar vlera 3,719,240 lekë nga mos arkëtimi i 5 kontratave për vitin 2023, si dhe nuk është arkëtuar vlera prej 1,200,000 lekë për 1 kontratë që i përket periudhës përpara vitit ushtrimor 2023 nga subjekti V. Sh.A. Në total vlera debitorë sipas kontratave është në vlerën 4,919,240 lekë e cila konsiderohet e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 5 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditim i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja për 5 subjekte me vlerë 21,171,780 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Devoll. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i nryshuar, neni 12, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

**Në mënyrë të detajuar lista e subjekteve paraqitet si vijon:**

Nr.	Subjekti	Debitore 31.12.2022	Lëvizja viti 2023		
		Vlera	Shtuar	Pakësuar	Gjendje 31.12.2023
1	V.	650,000	500,000	0	1,150,000
2	I.SHPK	300,000	300,000	300,000	300,000

3	A.	705,020	136,250	841,270	
4	M.	2,482,980	-	-	2,482,980
5	K.	17,238,800	-	-	17,238,800
	Total	21,376,800	936,250	1,141,270	21,171,780

Burimi: Bashkia Devoll

## IV GJETJE DHE REKOMANDIME

### A- MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

#### ***“Mjedisi i kontrollit”***

Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.

#### ***“Menaxhimi i Riskut”***

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

#### ***“Aktivitetet e Kontrollit”***

-Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup)apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

#### ***“Informimi dhe komunikimi”***

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

#### ***“Monitorimi”***

-Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 10-16 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrisë të Riskut, (iii) të ngrihet struktura e kordinatorit dhe grupit të menaxhimit të riskut, (iv) të garantohet se njoftimi/shpallja e vendeve të lira të punës, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

#### ***Brenda 6-mujorit të dytë 2024***

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në raportin vjetore të auditimit të programohen dhe vlerësohen fusha me risk të lart në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Bashkia Devoll nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhrin nr. 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të Angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e Përmbledhjes Ekzekutive: a) Rezultatet e auditimit; b) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga verifikimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës “Opinion i Përgjithshëm”, nuk është dokumentuar realizuar nga Njësia e Auditimit si dhe nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13, Urdhri nr. 4 dt. 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19 pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm, paragrafi 4.1.12, Kreu 6, paragrafin 6.3, Kreun IV, paragrafi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Të merren masa për të ngritur Komitetin e Auditimit, me qëllim rritjen e cilësisë të punës audituese

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Bashkisë Devoll rezulton se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 648,890 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 506,116 mijë lekë, ose në masën 78 %. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 281,095 mijë lekë dhe është realizuar në masën 82.3%. Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 212,257 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 133,824 mijë lekë, ose në masën 63%. Zëri transfertat korente të brendshme është planifikuar në vlerën 11,936 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 10,019 mijë lekë, ose në masën 84%. Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 3,921 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 3,432 mijë lekë, ose në masën 87.5%. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 113,620 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 93,529 mijë lekë, ose në masën 82.3 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosarketimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Devoll në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për

vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-30 të aporitit të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit si dhe drejtoritë/sectorët e tjerë të Bashkisë Devoll, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit dhe krijimin e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Devoll nuk ka shlyer në kohë detyrimet ndaj të tretëve sipas detyrimeve kontraktuale. Rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor vlerën 115,580,200 lekë dhe gjendja në fund të vitit 2023 rezulton në vlerën 93,897,067 lekë. Gjatë vitit 2023 janë likuiduar gjithsej 144,026,176 lekë dhe është shtuar me vlerën 122,343,043 lekë. Vlera totale e detyrimit në thesar rezulton prej 93,897,067, të cilat janë detyrime të Buxhetit të Bashkisë. Nga Bashkia Devoll konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të prapambetura gjatë vitit buxhetor, ku peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime. Këto detyrime të prapambetura janë krijuar nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 52, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-30 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Devoll dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke shmangur krijimin e detyrimeve të prapambetura.

*Menjëherë*

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave rezulton se Bashkia Devoll nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore sipas llojit të taksës/tarifës, respektivisht nga; -Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TPTH, - Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, -ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizmin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të

pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit si dhe të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencimit nuk ka hartuar regjistrin e abonentëve familjarë dhe private sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, Në regjistrim e mbajtur nga Bashkia Devoll gjendet si informacion vetëm lista emërore e personave të cilët duhet të ngarkohen me bazën e taksave. Regjistrim fizik i mbajtur nga Bashkia Devoll nuk është i plotësuar sipas abonentëve për detyrimet e tyre sipas paketës fiskale dhe pagesat e kryera prej tyre. Duke mos patur informacioni e saktë nga regjistri kjo do të sjelli edhe parashikim të gabuar për mbledhjen e taksave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i evidencave analitike të llogarive të aktiveve afatgjata, u konstatua se: Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë 3 (tre) projekte “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë, “Ndërtim ujësjellësi të jashtëm dhe të brendshëm, NJA Miras” në vlerën 6,887,520 lekë, “Projektim Ujësjellës i brendshëm në NJA Miras, nga E.” në vlerë 6,960,000 lekë (kosto historike). Këto projekte nuk duhej të kontabilizoheshin në këtë llogari pasi investimi për të cilin janë hartuar këto projekte ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë, e cila ka sjellë pasqyrim të pasaktë të kësaj llogarie, ulje të vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe llogarinë 213 “ rrugë rrjete e vepra ujore”.

Veprime të cilat kanë ardhur për shkak të mos njohjes së akteve ligjore e nënligjore për raportimin financiar, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1.Rekomandimi :** Drejtoria e Financës në Bashkinë Devoll të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës prej 15,409,520 lekë të 3 (tre) studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostonë së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogarinë përkatëse 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” sipas zërave për të cilën janë realizuar, për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë

*Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024*

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se:

-Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerë 767,647,588 lekë kosto historike, është përfshirë vlera 94,936,727 lekë (47,488,945 lekë nga ish-Komuna Qendër Bilisht + 47,447,782 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Qendër Bilisht dhe Hoçisht e paanalizuar. Këto vlera ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,404,624,620 lekë kosto historike në çelje të vitit 2023 dhe në vlerë 2,608,835,201 në mbyllje të vitit ushtrimor është përfshirë vlera 572,125,235 lekë (57,441 lekë nga ish-Komuna Miras + 338,481,513 lekë ish-Komuna Qendër + 233,586,281 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Miras, Qendër dhe Hoçisht. Për pasojë kjo mangësi ka ndikuar në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Për sa më sipër veprimet dhe mos veprimet janë në kundërshtime me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024*

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 26 “Aktive afatgjata financiare”, rezulton se në çelje të vitit ushtrimor Bashkia Devoll, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 7.76% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A me NUIS M.....N, me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 7,762 mijë lekë e cila nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022 dhe 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria e financës me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024, të marrë masa për regjistrimin e vlerës 7,762 mijë lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” të aksioneve të “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A me NUIS M.....N”, me qëllim paraqitjen e saktë të vlerave kontabël në pasqyrat financiare.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024*

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 150,085,559 lekë, në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të

investimeve” e cila paraqitet në vlerën 2,539,409 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”. Kjo vjen si pasojë e mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi dhe sjell mos kuadrim të llogarive kontabile. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës për pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

*Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024*

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 26,089,133 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5% e rakorduar me Degën e Thesarit Devoll. Nga analiza e llogarisë rezulton se për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,307,917 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Devoll, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,461,258 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Devoll, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2023 e më parë, për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 99,212,495 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,672,394 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,897,267 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 672,949 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 4,524,882 lekë ku totali shkon në vlerën 174,573,505 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 42,533,338 lekë, në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Rapiritit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206

“Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024.

### *Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024*

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Bashkia Devoll ka në total 2,987 pasuri nga të cilat 1,403 pasuri në pronësi dhe 1,596 pasur në përdorim sipas VKM-ve përkatëse nga ku rezulton se nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të asetëve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Devoll; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Korçë, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të asetëve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre si dhe nuk ka krijuar komisionit e përbashkët në zbatim të VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK ku kërkohet një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit me qëllim inventarizimin dhe regjistrimin dhe përditësimin e inventarëve. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30, pika 35/a si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV. VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK. ”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 57-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrëjë një grup pune me spacialistë të fushës dhe të marrë masa për të krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Devoll konstatohet se deri më datën 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën **14,421,928 lekë** shumë e cili i përket vetëm subjekte private. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, për subjektet private është krijuar borxhi tatimor në vlerën **2,480,171 lekë**. Ndërsa debitorët familjarë për vitin 2023 janë në vlerën **15,863,278 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore gjendje 31.12.2023, janë në vlerën **30,285,206 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit si dhe të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor

për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 30,285,206 lekë**, e cila përbëhet nga:

**-15,863,278 lekë** detyrime nga **abonentët familjarë**;

**-14,421,928 lekë** detyrime nga **biznesi i madh**;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

**Menjëherë**

**2.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Devoll në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

